

JORGO PANAJOTI

ÇËSHITJE TË STUDIMIT TË ANEKDOTAVE POPULLORE

Populli është autor jo vetëm i krijimeve poetike që dallohen për frymën epike, për fantazinë e pasur e të organizuar apo për lirizmin e thellë e të hollë, por edhe i krijimeve humoristike e satirike. Elemente të humorit dhe të satirës gjejmë në shumë krijime folklorike, qofshin këto në prozë a në poezi; po ka asish, për të cilat humori dhe satira janë diçka karakteristike, janë tipare organike. Midis këtyre të fundit një vend të veçantë zënë anekdotat.

Kuptimi i sotëm i kësaj fjale është larguar shumë nga kuptimi i saj i parë.¹ Ne po e përdorim për të shënuar ato krijime folklorike, që në popull njihen me emra të ndryshëm: *shpotina*, *përrallëza* apo *histori për të qeshur*, *mesele*, *shaka*, *bende*, *dumbara*, *turehate* etj.

Anekdotat, si një formë e veçantë e tregimit folklorik, është mjaft e përhapur dhe e gjallë në popullin tonë.

Ajo është përdorur me shkathtësi nga populli për të fshikulluar shtypësit; është përdorur e përdoret për të demaskuar armiqtë e vet të klasës, për të vënë në lojë negativen, për të shprehur ide dhe dëshira të ndryshme. Një popullaritet e vitalitet i tillë lidhet me faktin se anekdotat hyjnë në radhën e atyre krijimeve folklorike që, me përmbajtjen e tyre, me formën e shkurtër, me elasticitetin dhe mprehtësinë, me karakterin humoristik e satirik, u përgjigjen më mirë kërkesave dhe nevojave ideore, estetike dhe etike të kohës e mund të zbatohen me shkathtësi lidhjen me realitetin. Dhe, duke folur për njerëz, episode e shfaqje të jetës reale dhe për qëndrimin e popullit ndaj tyre, anekdotat na çojnë në rrjedhën e madhe të jetës, na japin njoftime interesante për marrëdhënjet shoqërore dhe jetën e përditshme të njerëzve, na bëjnë të njohim sa më thellë shpirtin e popullit ndër shfaqjet e ndryshme të jetës së vet. Nga ana tjetër, me forcën e madhe vepruese dhe komunikimin e fuqishëm me dëgjuesin, anekdotat luan një rol të rëndësishëm gjatë bisedës. Ajo, ashtu si proverbialja, po të përdoret me vend, kryen me shkathtësi rolin e argumentit, parabolës, shigjetës së mprehtë kundër kundërshtarit. Kjo i jep gjallëri dhe forcë bisedës apo ligjëritimit². Duke çmuar këtë rol të anekdotës, për të përcaktuar më mirë qëndrimin e vet ndaj njerëzve dhe ngjarjeve, njeriu i popullit e ka zakon të tregojë një histori të vogël ose shpesh pyetjeve tona u përgjigjet me një anekdotë. Dhe kujtesa e tij ruan një sasi të konsiderueshme anekdotash, të gatshme për të hyrë në punë atje ku duhet.

Rëndësia njohëse, edukative dhe artistike e anekdotave është vlerë-

1) Si mbiemër ka kuptimin «i pabotuar» (nga greqishtja *avëzdotov*).

2) Le të kujtojmë, p.sh., me sa sukses i përdorte anekdotat F. Noli në fjalimet e tij (*Hosteni* 23/1953. f. 3 etj.)

suar pozitivisht edhe nga klasikë të marksizëm-leninizmit, edhe nga studjues të folklorit, edhe nga personalitete të ndryshme. Engelsi, p.sh., ka folur me entuziazëm për mprehtësinë e anekdotave dhe për aftësinë e tyre, që vënë në lojë të metat e njerëzve.³

Por duhet thënë se, në krahasim me llojet e tjera të krijimtarisë folklorike, anekdota është lënë disi larg vëmendjes së folkloristëve, duke u konsideruar, me sa duket, si krijim «i vogël». Ndërkaq, pavarësisht nga qëllimet dhe kriteret, në letërsinë folklorike të vendeve të ndryshme gjejmë mjaft botime dhe studime për anekdotat, por gjykimet shpesh kontradiktore e të vështuarit e çështjeve nga pozita të ndryshme ideologjike, estetike e shkencore tregojnë se për zgjidhjen sa më të saktë të problemevet të tilla si vendi i anekdotës midis llojeve të tjera të tregimit folklorik, specifika e përmbajtjes dhe e formës së saj, kriteret e klasifikimit etj., ka vend për diskutime të mëtejshme.

Lidhur me problemin e parë, p.sh., mendimi më i përgjithshëm është se anekdotat përbëjnë një lloj të veçantë përrallash; ka edhe mendime se ato nuk mund të qëndrojnë në gjininë e përrallave, prandaj duhen konsideruar si një zhanër me vete i prozës folklorike. Në përpjekjet e të dy palëve për të argumentuar mendimin e tyre shpesh bie në sy një farë formalizmi e një krahasim empirik i anekdotës me përrallën, ku më shumë flitet për tiparet që s'kanë anekdotat se sa për ato që janë karakteristika të tyre. I paargumentuar dhe jo i drejtë na duket dhe kuptimi shumë i gjerë që i jepet ndonjëherë anekdotës, duke përfshirë edhe përrallat humoristike të tipit «Qoset dhe bujku»,⁴ tek ne.

Po kështu, pikënisja dhe kriteret e klasifikimit si të përrallave në përgjithësi, ashtu edhe të anekdotave në veçanti, janë të ndryshme tek studjuesit e ndryshëm. Ka, p.sh., propozime për klasifikimin e anekdotave duke u bazuar kryesisht tek personazhet e tyre. Një kriter i tillë klasifikimi nuk mund të jetë krejt i saktë, sepse, siç dihet, shpesh në anekdotat e njëjta ide apo ngjarje u vishet personazheve të ndryshme; veç kësaj, ka personazhe, p.sh. Nastradini, që, nga pikëpamja e tipit shoqëror që paraqesin, herë vihen në këtë e herë në atë rol. Në këto raste grupimi i anekdotave thjesht simbas emrit të personazhit do të ishte një gjë formale. Prandaj na duken më të drejta propozimet për klasifikimin e anekdotave simbas kriterit tematiko-ideor⁵.

Ekzistenca e paqartësive dhe e mendimeve kontradiktore lidhur me problemet për të cilat u bë fjalë më lart duket edhe në përpjekjet për përkufizimin e anekdotës, së pari, në tendencën për të evituar dhënjën e një përkufizimi të tillë dhe, së dyti, në dhënje përkufizimesh jo të plota e të ndryshme. Këtu bie në sy fakti se përkufizimet e gjertanishme të anekdotës bazohen kryesisht tek anët e saj formale e jo tek

3) Simbas E.V. Pomjerancevës, *Russkie narodnye skazki*, Moskë 1963, f. 95-96.

4) PP-I (*Folklor shqiptar, I-Proza popullore*, v. I, Tiranë, 1963) përralla nr. 65; khs Aarne-Thompson, *The types of the Folk-Tale*, Helsinki, 1928, nr. 1539.

5) Sabina C. Stroescu. *Cu privire la sistemul de clasificare a snoavei populare românești*, «Revista de Etnografie și folclor» 6/1965, f. 585-587 (Bukuresht); S. Siyavuşgil, *Une essai d'analyse psychologique d'anecdotes populaires turques*, «I-er congrès international des études balkaniques et sud-est européennes. Résumés des communications — Littérature et folklore», Sofje, 1966, f. 215-216 etj.

veçoritë dhe tiparet e përmbajtjes e as tek cilësia e objektit të saj të pasqyrimit: por edhe në këtë rast theksohen vetëm disa tipare që i gjejmë, edhe sikur t'i marrim së bashku, dhe te llojet e tjera të tregimit folklorik, ndërsa lihen larg vëmendjes tipare të tjera po aq ose më shumë të rëndësishme. Në shumicën e përkufizimeve të gjertanishme, p.sh., përmenden si karakteristika të anekdotës shkurtësia, karakteri humoristik dhe përfundimi i papritur; të tria këto i gjejmë, fjala vjen, edhe te fabulat «U poqnë gorricat se më hahen mua», «Ulku dhe poçari», «Ulku e kali»⁶ apo përralla realiste-humoristike «Mangut për tre samarë»⁷ etj. Prandaj ne mendojmë që në përkufizimin e anekdotës duhet të theksohen edhe tipare të tilla si karakteri realist, të bazuarit e saj në një fakt të vetëm komik si dhe ekzistenca tek ajo e një pike të vetme kulminante të shprehur në mënyrë të mprehtë. Siç do të mundohemi të tregojmë më poshtë, këto tipare janë dalluar për anekdotat.

Sigurisht, për zgjidhjen e këtyre problemeve duhet që, duke u nisur nga kritere të shëndosha ideo-estetike dhe shkencore, anekdota të studjohet si nga pikëpamja e përmbajtjes, ashtu edhe nga pikëpamja stilistiko-strukturale e funksionale, sepse, siç u tha që në fillim, ajo lot një rol njohës, artistik dhe socialo-etik,

Rreth anekdotave popullore shqiptare nuk kemi ende një studim të veçantë, sado panoramik, me përjashtim të trajtimit të tyre nga shoku Zihni Sako⁸, ku ngrihen në mënyrë sintetike disa nga çështjet më të rëndësishme. Më shumë është shkruar për ndonjë personazh të veçantë të këtyre anekdotave, si për Nastradin Hoxhën, Xhuhain, Oson e Falltores⁹.

Diçka më ndryshe paraqitet puna me botimin e anekdotave. Një botim të veçantë, pak a shumë të plotë, të tyre, nuk kemi, por i gjejmë sigurisht të shpërndara ndër botimet e ndryshme folklorike si edhe në shtypin periodik e të përditshëm, pavarësisht se shpesh ato janë botuar jo me qëllime folkloristike por gjuhësore, prandaj përmbajtjes i kushtohet pak kujdes (botimet e shumicës së dijetarëve të huaj) apo për variacion, prandaj dhe pa kritere të sakta shkencore e me interes të kufizuar si material folklorik (botimet në shtypin e përditshëm e periodik, ku gjejmë dhe anekdota të përkthyer nga përmbledhje të huaja ose anekdota me origjinë jo popullore). Midis botimeve që përmbledhin një sasi të konsiderueshme anekdotash vlen të përmendet *Bëleta shqiptare* e Th. Mitkos (1878), *Zur albanesischen Sprachkunde* (1881) *Prispevky ky poznáni nařeči Albanskych* (1883) e J. U. Jarnikut, *Albanesische Studien V* (1896) e G. Majerit, *Folklorë... II* (1940) me materiale mbledhur nga Gj. Karma, *Tregime popullore I Drenicë* bl. I (1963) e Anton Çettës si dhe *Nastradin Hoxha* i Dh. Kotit (pa datë); kurse nga revistat e gazetat dallohen *Cirka*, *Ora*, *Kopështi letrar* etj., para çlirimit, dhe, në mënyrë të veçantë, *Hosteni*, pas çlirimit.

Përsa i përket mbledhjes së anekdotave, ashtu si për të gjitha krijimet folklorike, një punë mjaft e mirë dhe e organizuar është bërë pas

6) PP-I fabulat nr. 3, 6, 7.

7) A. Çetta, *Tregime popullore*, I, Drenicë, bleni i parë, Prishtinë, 1963, f. 182-183.

8) *Historia e letërsisë shqipe*, v. I, Tiranë 1959, f. 59-60.

9) Sakoli (Hil Mosi), *Kalendari i shoqërisë «Dija», për vjeten 1908*, f. 61-64; M. Lambertz, *Albanesische Märchen* Vienë 922, f. 53-64; «Leka»; 2/1936; f. 20; T. Gjeorgjeviç, *Nastradin Hoxha i arnauti*, «Priolozi...» Beograd 1937.

çlirimit. Këshu dhanë kontributin e tyre të çmueshëm Z. Sako, K. Harito, Q. Haxhihasani, Gj. Sheldia, M. Zaloshnja, M. Muho etj.. Si rezultat në Arkivin e sotëm të Institutit të folklorit ka një sasi të konsiderueshme anekdotash.

* * *

Numri i anekdotave, i subjekteve anekdotike dhe i varianteve është mjaft i madh në popullin tonë, mund të themi, më i madh se ai i llojeve të tjera të tregimit folklorik; megjithatë, ato përbëjnë një tërësi organike, gjë që përcaktohet nga problematika ideore, nga uniteti i konfliktit bazë, nga qëllimshmëria, nga situata e përfundimi dhe nga karakteri i personazheve. Atë ndjekin, si të thuash, një vijë të caktuar logjike, një tematikë të caktuar, ku spikasin probleme të tilla si padrejtësia shoqërore, kontrasti midis pasurisë dhe varfërisë, liria dhe pavarësia, lumturia dhe fatkeqësia, e mira dhe e keqja etj. Prandaj, duke marrë parasysh linjën kryesore të çdo anekdote, mund të dallojmë disa familje ose grupe tematike, si anekdota rreth *marrëdhënjeve klasore*, rreth *marrëdhënjeve familiare* dhe rreth *karakteristikave individuale* të njerëzve. Sigurisht, në çdo grup anekdota mund të formojnë nëngrupe e cikle të veçanta, simbas çështjes që trajtohet në to. Kështu, p.sh. në grupin e parë gjejmë anekdota në të cilat bëhet fjalë për marrëdhënjet zotëri-shërbëtor, për shtetin dhe administratën shtetërore, për klerin etj.

Duke dhënë aspekte nga realiteti ekonomik, shoqëror e politik i së kaluarës, anekdota zbulon ndarjen e shoqërisë në njerëz që kishin grumbulluar në duart e tyre mjetet e prodhimit e në njerëz krejt të xhveshur prej tyre dhe, rrjedhimisht, në shtypës e në të shtypur. Në kategorinë e parë anekdota fut feudalët, borgjezët e pasur (tregëtarët, sarafët etj.), nepunësit e lartë të shtetit, klerikët batakçinj, akoma dhe intelektualët që jetonin të shkëputur nga masat e në kurriz të tyre. Të gjithë këta, simbas anekdotës, ishin parazitë, që majmeshin duke thithur gjakun e njerëzve të thjeshtë, duke i shfrytëzuar këta me të gjitha mjetet dhe mënyrat. Siç pohohet në anekdotë, këta grabitqarë kishin thirrjen e tyre luftarake, kur sulleshin drejt viktimave: «O burra, hani sa të mundni, se kanë dhjamë akoma!».

Alogjizmin e kësaj gjendjeje anekdota e vë në dukje dhe e fshikullon duke na dhënë episode dhe situata nga më komiket. Mbreti, p.sh., për ta «lehtësuar» popullin nga barra e rëndë që i kish vënë paraardhësi i tij — malin ta bëjnë fushë — kërkon që fusha të bëhet mal;¹⁰ beu i cfilit argatët aq shumë në punë, sa që këta «harrojnë të gjitha shartet»;¹¹ zotëria shpik punë nga më të rëndat dhe nga më kapriciozet për shërbëtorin, ndërsa për ushqim i jep vetëm bukë e hurrë; një mori nepunësish sulen kush t'i xhvatë më shumë ryshfeteqytetarit të thjeshtë hallexhi¹² etj. etj.

Anekdota tregon gjithashtu se, veç shtypjes dhe shfrytëzimit ekonomik, masat popullore në të kaluarën i nënshtroheshin dhe shtypjes shpirtërore: mbi to rëndonin me një peshë dërmuese kanunet patriarkale e feudale, morali borgjez e fetar.

10) AIF, Min. Ar. (Arkivi i Institutit të folklorit, materiale nga Ministria e Arësimit), dosje, 5, fl. 21, f. 31,

11) A Çetta, *vep. cit.*, f. 223.

12) AIF, MZ (Mojsi Zaloshnja); fl. 5; f. 1.

Këtë anë të shtypjes shoqërore e zbulojnë me shkathtësi dhe e stigmatizojnë anekdotat për predikuesit e moralit të klasave shfrytëzuese — kadiu, prifti, hoxha etj., të cilët kërkonin prej popullit të zbatonte ato parime, që vetë atyre s'do t'u pëlqente t'i zbatonin kurrë si dhe anekdotat për viktimat e kësaj shtypjeje, për ata njerëz të thjeshtë të popullit që, duke qenë të infektuar me supersticione dhe paragjykime absurde ose të trullorur prej kanuneve mesjetare, bien në pozita me të vërtetë tragjikomike (le të kujtojmë malësorin që kërkon të shpëtojë nga varfëria nëpërmjet fesë, po nuk arrin gjë tjetër veçse të shtojë mundimet e veta ¹³, apo fshatarin e varfër që vonë merr vesh se frazat që përdorin klerikët për diçka si ndjenjë kolektiviteti duhen marrë pikërisht me kuptimin e kundërt ¹⁴ etj.).

Shpeshherë shtypja shoqërore e masave punonjëse në të kaluarën shoqërohej dhe me shtypjen kombëtare. Për këtë aspekt të realitetit të së kaluarës bëjnë fjalë anekdotat rreth pushtuesve turq, shovinistëve fqinj, imperialistëve dhe nazifashistëve. Të gjithë këta për shtypësit e brendshëm mbase ishin «meleq të zotit», por për popullin ishin «bash si dreqi i mallkuar».

Një aspekt tjetër i realitetit të së kaluarës, që del qartë në anekdotat tona popullore nëpërmjet fakteve nga më të ndryshmet e nga më tipiket, është mjerimi, varfëria e injoranca e thellë dhe e padurueshme e masave popullore. Në anekdotat rreth kësaj teme dalin familje fshatare që të gjitha shpresat i kanë të lidhura me lopën a dhinë e vetme, argatë gjysëm të uritur e gjysëm të xhveshur, endacakë të mjerë që s'kanë ku të fusin kokën, fëmijë që si gjellë të preferuar kanë gjizën etj. Patosi kritik dhe humori i këtyre anekdotave buron nga bindja e thellë se rendi shfrytëzues është i papajtuësëm me përparimin shoqëror dhe me arritjen e një mirëqenijeje të vërtetë për shumicën e njerëzve. Qëllimi i vërtetë i këtyre anekdotave është të sulmojnë padrejtësinë shoqërore e jo të tallen me viktimat e kësaj padrejtësie. Njeriu vë me hidhërim buzën në gaz, p.sh., kur dëgjon se i urituri, në vend që t'i lutet përëndisë «nëmë një karroqe misër», ngatërrohet e thotë «bëmë kokën sa një karroqe» ¹⁵, apo kur dëgjon se qytetari pa punë, pa shtëpi e katandi, provokon një incident me policin për të kaluar dimrin në burg ¹⁶; por s'ka si mos t'i vijë keq për këta njerëz të mjerë e si mos të urrejë shkaktarët e këtij mjerimi.

Në kushtet e sundimit të marrëdhënjeve shfrytëzuese vendi i njeriut në shoqëri dhe vlera e tij vareshin nga pasuria; prandaj personaliteti i njeriut të thjeshtë ndrydhej e mirrej nëpër këmbë, kurse ndaj njeriut të pasur silleshin me servilizëm e lajka. Ja pse nuk i besojnë të varfërit kur thotë se «miu më hëngri një çyrek bukë», ndërsa pranojnë si të vërteta fjalët e të pasurit se «mua miu më hëngri plorin ¹⁷»; ja pse, siç tregon anekdota, në regjimet antipopullore të së kaluarës ka pasë nëbunës të lartë, deputetë, qeveritarë etj. kreit të paaftë, injorantë, trashanikë e dembela, që kishin arritur poste të larta vetëm në sajë të parasë e të miqve.

13) AIF, Gj. Sh: (Gjush Sheldia), fl. 24, f. 3

14) AIF, MZ, fl. 15, f: 14:

15) AIF, MM (Musa Muho), fl. 8, f. 28

16) AIF, Gj.Sh. fl. 13/2, f. 336.

17) Th. Mitko, MHFSH-II (Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, v. II, Tiranë, 1961), f. 252.

Në këto rrethana revolta e masave popullore kundër shfrytëzimit të padurueshëm e rendeve antipopullore dhe urrejtja kundër shtypësve e shfrytëzuesve, qofshin këta të brendshëm a të jashtëm, janë diçka krejt logjike dhe e paevitueshme. Këto ndjenja dalin tek anekdota herë në mënyrë të hapur, të drejtpërdrejtë e herë në mënyrë të tërthortë por gjithnjë janë të thella e të fuqishme. Diku këto shprehen nëpërmjet fjalëve dhe dëshirave të të shtypurit (p.sh., te dëshira e fshatarëve që t'i shohin bejlerët jo vetëm pa hundë, por dhe pa kokë, apo te mallkimi «u tretët dreqi farën» i një gruaje të popullit ndaj turqve), diku përmjet qëndrimit të tij tallës e përbuzës ndaj shtypësve; por shprehje më e qartë e revoltës dhe e urrejtjes së masave punonjëse është lufta e tyre e vazhdueshme klasore, luftë që zhvillohet me të gjitha mjetet dhe mënyrat e mundshme.

Arma më e zakonshme që përdor njeriu i thjeshtë, i shtypuri, si personazh pozitiv i anekdotës, në luftën e vet klasore është zgjuarsia dhe mprehtësia. Me anën e kësaj arme ai zbulon dhe fshikullon pa mëshirë dobësitë dhe tiparet negative të armiqve të vet të klasës; nxjerr në shesh kontradiktat e brendshme të moralit të klasave sunduese, apo kontradiktat midis fjalëve dhe veprave të demagogëve, politikanëve dallaveraxhinj e mashtuesve të çdo kallëpi; zbulon politikën reaksionare të regjimeve antipopullore, karakterin e vërtetë të administratës së këtyre regjimeve, fytyrën e autoritetit laik, duke filluar nga kryetari i shtetit; zgjidh me sukses detyrën ose enigmën që i japin dhe kapërcen situatat e vështira. Gjithashtu, i pajisur me këtë armë dhe duke shfrytëzuar me mjeshtëri dobësitë e armikut të vet të klasës, i shtypuri ja hedh atij me njëmijë mënyra, si me fjalë e me vepra, prandaj nganjëherë protesta dhe lufta e tij merr dhe formën e një vjedhjeje, mashtrimi apo gënjeshtre të shkathtë. Veçse populli nuk mbron as hajdutllëkun, as gënjeshtren e as mashtrimin në vetvete, në kuptimin e zakonshëm të fjalës (përkundrazi, këto, si tipare negative e të dëmshme, vihen në lojë e kritikohen), sepse këto shfaqje dalin në anekdotat si diçka që diktohet nga nevoja për të jetuar me një farë mënyre në shoqëri ku njeriu i thjeshtë s'ka asnjë siguri e mjet jetese; ato kryhen në dëm të shfrytëzuesve e të atyre që kërkojnë të poshtërojnë njeriun e thjeshtë. Këtu, fjala vjen, s'kemi të bëjmë me hajdutë profesionistë, ordinerë. Vjedhjet i kryejnë njerëz të zakonshëm, që s'kanë «as bukë për të shujtë ujen», që «s'kanë punë e asnji pare me vedi». Këta vjedhin jo pa kriter: Nastradini vjedh paratë e mbretit; varfanjaku vjedh priftin, beun, kadinë, pasanikun; i z bathuri vjedh këpucarin e pasur etj. Kjo lloj vjedhjeje, pra, është për anekdotën si hakmarrje kundër padrejtësive shoqërore, si mjet jetese që vetë shoqëria antagonistë ja jep njeriut të thjeshtë. Ajo, po të shprehemi me fjalët e Gorkit, «është një lloj lufte partizane e disa individëve të veçantë kundër pronës borgjeze». ¹⁸

Në të gjitha anekdotat, ku kemi, si të thuash, garë zgjuarësie midis personazheve, pothuajse gjithmonë fitorja është në anën e njeriut të popullit, sepse (kjo është ideja mbi të cilën janë ndërtuar këto anekdota) me anën e tij është e drejta, zgjuarësia, forca morale. Kjo shpreh endërrën e popullit për marrëdhënje më të drejta shoqërore dhe bindjen e thellë në mundësinë e realizimit të kësaj ëndërre. Por utopizmi i idesë se fitorja mbi shtypsin mund të arrihet me mjete të tilla, siç është

18) *Estetika dhe letërsia*, v. II, Tiranë 1962, f. 461.

zgjuarsia dhe mprehtësia, nuk mund të mos vihet re nga vetë populli. Ja pse në një sërë anekdotash aprovohet pa rezerva dhuna si mjet më efikas në luftën klasore të të shtypurit. Tipike është, fjala vjen, anekdota që tregon se një djalë, në kundërshtim me këshillat e babait — «mos i kundërshtoj së keqes me dhunë» — rrëzon nga minareja e xhamisë hoxhën imoral dhe fjalëve të babait «a nuk të thashë se zoti ka me e dënue» u përgjigjet: «Po, por m'u desh edhe mue me i ndihmue paksa zotit»¹⁹. Aprovimi dhe përdormi i dhunës nga masat popullore në luftë kundër armiqve të tyre të klasës duket më shumë në anekdotat që flasin për forma më të organizuara e më të larta të luftës klasore, si lufta e armatosur kundër pushtuesve të huaj e kryengritja.

Anekdotat na jep aspekte nga fusha të ndryshme të luftës klasore midis të shtypurit dhe shtypësit, nga fusha ekonomike, politike dhe ideologjike.

Sigurisht këto aspekte anekdotat na i jep në përputhje me metodat dhe mundësitë e saj të pasqyrit të realitetit dhe me mjetet që disponon. Po kështu, gjithnjë në përputhje me këto mundësi, anekdotat tregojnë se format, mjetet, shkalla e organizimit dhe drejtimet e luftës klasore të masave të gjera punonjëse kanë qenë të ndryshme në periudha të ndryshme historike. Kjo lidhet me një sërë faktorësh objektivë e subjektivë të kushtëzuar historikisht. Kështu p.sh., kufizimet ideologjike të masave punonjëse në të kaluarën si dhe presioni i ideologjisë së klasave sunduese, si ideologji sunduese, kanë bërë që në disa anekdotat të depërtojnë ide që propagandonin dhe përhapnin për interesat e tyre klasat shfrytëzuese — fatalizmi, nënshtrimi, individualizmi etj., por në pjesën dërmuese të anekdotave shihet qartë aftësia e popullit për t'u orientuar drejt edhe në situatat më të komplikuar, për të larguar mjegullën me të cilën klasat sunduese përpiqeshin të mbulonin esencën reaksionare të politikës dhe ideologjisë së tyre. Prandaj, si rregull, tek anekdotat kundërshtohen ato parime ideologjike, etike, qëllimi i të cilave ishte shtypja, ndrydhja e marrja nëpër këmbë e personalitetit të njeriut të thjeshtë, përjetësimi i marrëdhënjeve shfrytëzuese.

Sa thamë, i vëmë re qartë, midis të tjerave, edhe tek anekdotat për fenë dhe klerin. Këto dëshmojnë në mënyrë elokvente se populli ynë, edhe në kushtet e shtypjes dhe paditurisë së tmerrshme të së kaluarës, megjithëse ka besuar te perëndia, në thelb, s'ka qenë kurrë fetar, mistik. Në fakt, tek anekdotat me të vërtetë popullore vihet në lojë besimi i verbër, del një skepticizëm i theksuar ndaj gjithshkaje të shenjtë, skepticizëm që arrin deri në përbuzje, bile në afetarizëm dhe në antifetarizëm.

Kështu, nëpërmjet anekdotës, populli kundërshton e vë në lojë parimin fetar «mos i kundërshtoj së keqes me dhunë» dhe e konsideron këtë parim si fyes për njerinë; fshikullon pa mëshirë parime të tjera të tilla si «njeriu me njerinë janë vëllezër», «jep më shumë e merr më pak», duke menduar se në shoqërinë me klasa antagoniste këto janë parrulla boshe dhe në favor të klasave shfrytëzuese²⁰. Edhe ndaj predikimeve se «zoti është krijues i gjithçkaje²¹, gjykatës i lartë e i drejtë» se «kujdeset si bariu për delet e veta» etj. populli sillet me shumë rezerva, bile me ironi. Një qëndrim i tillë reflekton besimin e thellë te forcat e njeriut,

19) Gj. Karma, *Folklor...* II..., Shkodër, 1940, f. 139.

20) «Asht gzim ma i madh me dhanë se me marrë», predikon dikush; p.sh. «Po; sidomos shputa», i përgjigjen (AIF, GjSh, fl. 1, f. 142).

21) Edhe sikur të jetë kështu, mendohet në një anekdotë, prapë zoti del usta i keq, se ka krijuar dhe gjëra të panevojshme (AIF, MZ, fl. 15, f. 6).

te aftësia e tij për ta krijuar vetë fatin e tij, për të luftuar me sukses kundër së keqes pa ndërmjetësinë e krijimeve të tilla imagjinare siç është zoti. Ja pse anekdota tregon se ka rezultate konkrete e pozitive vetëm atëhere kur njeriu lëviz e lufton vetë, kurse në rastet kur ai rri e lutet jo vetëm që zoti s'duket asgjekundi, por, nganjëherë, kërkesa kthehet në të kundërtën e saj. Dikush, p.sh. i lodhur nga rruga e vështirë, i lutet perëndisë t'i çojë një kalë për të nxjerrë të pëpjetën; por, në vend të kalit të shalës i del përpara një suhari, që e detyron të mbajë në kurriz mëzin e pelës së vet²². E pabesueshme dhe qesharake i duket popullit edhe përralla fetare e jetës së përtejvarrit. Për të qoftë parajsja, qoftë ferri janë në tokë. Kjo është arsyeja që e bën malësorin t'i thotë priftit, kur ky predikon «kujdesin ndaj shpirtit» «Prifto, ky shpirti im, në më ndigjofte mue, rri këtu ke unë, se mirë asht; në s'më dëgjofte e del, atëhere dalshin e e shilofshin shtatëqind mijë dreqën!»²³.

Më në fund, tek anekdotat nga më thumbueset e nga më banalet për predikuesit fetarë, për «përfaqësuesit e zotit në tokë» — hoxha, prifti, etj. — për njerëzit që shkojnë në kishë a në xhami të shtyrë nga rutina e zakoni, që s'dinë të falen, apo, pasi falen pendohen, që përdorin gjithato marifete e hile gjatë agjirimit, që truajnë e blasfemojnë pa të keq, që para vdekjes s'dinë ç'të zgjedhin si «seli të shpirtit», kishën apo xhaminë etj., etj., në këto anekdota, pra, populli ynë del me një farë besimi fetar jo të ndërgjegjshëm, po për inerci, pa ekzaltime mistike, me një tolerancë të madhe fetare, me mendje të shëndoshë dhe me aftësi gjykimi të qartë.

Një pjesë anekdotash, në të cilat flitet për marrëdhënje klasore, janë krijuar gjatë Luftës nacionalçlirimtare ose pas çlirimit. Kto anekdota dallohen nga ato tradicionalet për ndërgjegjen e lartë klasore, për qartësinë politike, për frymën e partishmërisë proletare që i përshkon.

Disa prej tyre, nëpërmjet faktesh të ndryshme, sjellin njoftime interesante nga lufta e popullit tonë, nën udhëheqjen e Partisë, kundër pushtuesve nazifashistë dhe tradhëtarëve të brendshëm. Kështu, te fjalët e një qytetari, i cili kërkon si meze «një gjerman të fërguem»²⁴, ne ndjejmë urrejtjen e thellë të popullit tonë ndaj pushtuesve; te fjalët «ju s'jeni as bishti, jo balli»²⁵, që një plakë e varfër u përplas në surrat disa ballistëve, shohim qëndrimin e popullit tonë ndaj tradhëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të pushtuesit, ndaj politikës së tyre antipatriotike dhe reaksionare, ndaj parullave të tyre demobilizuese; episodi komik që na jep një anekdotë — vendimi idiot i qeverisë kuislinge për t'u prerë bur-sën disa konviktorëve që kishin dalë partizanë²⁶ — na bën të njohim rrugën e rinisë e të gjithë popullit tonë për fitoren e lirisë kombëtare e shoqërore.

Në një sërë anekdotash populli ynë jep aspekte nga marrëdhënjet kapitaliste në prodhim e nga kontrasti i madh midis pasurisë dhe varfërisë në shtetet kapitaliste, fshikullon politikën imperialiste të grabitjes pa skrupull e të shtypjes së çdo lirie dhe të drejte, politikën koloniale, racizmin e tërbuar etj. Paraqitja e episodeve ku bëhet, p.sh. paralelizëm midis rrugëve të Athinës dhe koridoreve të burgut²⁷, midis ish-presidentit amerikan Truman dhe kriminelit²⁸ etj., dëshmon për mprehtësinë, aftësinë

22) AIF, ShSh (Shaban Sheshori), fl. 8, f. 11.

23) Hosteni, 8/1959, f. 10.

24) AIF, GjSh, fl. 2/1, f. 272.

25) Z. Sako, *Folklori shqiptar*, T. 1956, f. 189.

26) Hosteni, 16/1955, f. 7.

27) Po aty, 189/1950, f. 4.

28) Po aty, 138/1949, f. 4.

për të kapur anët më tipike, lidhjen e ngushtë me realitetin dhe sensin e theksuar politik të këtyre anekdotave.

Shpeshherë shigjetat e mprehta të satirës popullore anekdota jua drejton revizionistët modernë, duke ju çjerrë atyre maskën e duke vënë në dukje tradhëtinë e tyre ndaj marksizëm-leninizmit e çështjes së proletariatit. Këto anekdota demaskojnë jo vetëm revizionistët sovjetikë, si social-imperialistë e neo-kolonialistë, që «hanë në një çanak me amerikanët», por edhe klikat e tjera revizioniste, si lakej të të parëve, servila e pa dinjitet, që hedhin hapin pas havazit të padronëve, ose, siç thotë anekdota, përdorin çadrën edhe në ditët me diell, sepse «bie shi në Moskë».

Siç u tha edhe më lart, disa anekdota e marrin temën nga jeta dhe nga marrëdhënjet në familje. Është e vërtetë se këtu gjejmë shfaqje që, në plan të gjerë shoqëror, inkuadrohen në sistemin e përgjithshëm të marrëdhënjeve klasore antagonistë (patriarkalizmi, pozita inferiore e gruas etj.), gjejmë tipare individuale që dalin edhe në grupin e anekdotave rreth karakteristikave individuale; por këto shfaqje e tipare si dhe personazhet që i mbartin, lëvizin brenda një rrethi të caktuar shoqëror (në familje), megjithëse ky rreth nuk është, sigurisht, i izoluar. Nga ana tjetër, qëllimi i anekdotave për të cilat bëjmë fjalë është të ngrejnë probleme që shqetësojnë në radhë të parë këtë rreth, të japin mendime për organizimin e këtij rrethi. Të gjitha këto e bëjnë të nevojshëm grupimin e këtyre anekdotave. Në këtë grup anekdotash dallojmë disa nëngrupe ose cikle tematike, si ato për marrëdhënjet midis burrit e gruas, prindit dhe fëmijës, vjehrrës dhe nuses, midis vëllezërve etj.

Disa prej këtyre anekdotave komizmin dhe trillimin e tyre e harxhojnë për të vënë në lojë burrin naiv e brinar, gruan dinake e jo besnike, apo dashnorin e zënë ngushtë. Veçse karakteristikë e këtyre anekdotave nuk është pasioni i veçantë rreth temës së dashurisë, por pohimi se shfaqje të tilla jonormale duken në kushtet kur njerëzit nuk kanë liri ndjenjash, në kushtet e martesave jo të përshtatshme e të detyrueshme. Në këto raste veprimet e gruas paraqiten si hakmarrje, si protestë kundër padrejtësive të shoqërisë ndaj saj. Nga ana tjetër, populli vë në lojë xhelozinë e tepruar të burrit, ironizon mendimin se gruas mund t'i imponohet ndershmëria duke e mbajtur në shtëpi, apo «në fre».

Po kështu, anekdotat e grupit që po trajtojmë vënë në lojë e kritikojnë shfaqje të tjera jonormale në familje, si kapadaillëkun dhe sjelljet arrogante të burrit apo kryeneçësinë e tepruar të gruas, tekmat e vjehrrës dhe trajtimin e keq të nuses apo sjelljet jo të arësyeshme të nuses ndaj vjehrrës, kërkesën për bindje të verbër ndaj babait apo trajtimin jo të mirë që djali i bën babait të plakur, përpjekjet e disa prindërve për të edukuar fëmijët me leksione, duke harruar shembullin personal etj.

Siç mund të vihet re, populli ngre drejt shumë probleme familjare, ka mendime përgjithësisht të drejta rreth ndërtimit të familjes, por kushtet ekonomiko-shoqërore dhe presioni i ideologjisë e i kanuneve të vjetra kanë bërë që shpesh këto pikëpamje të drejta të errësohen nga ide konservatore, patriarkale e antinjerëzore për të drejtat despotike të burrit në familje, nga pikëpamjet diskriminuese për gruan apo nga ideja se gruaja e ka në gjak gënjeshtëri, mashtrimin dhe dinakërinë. Duket qartë se paragjykimet e së kaluarës janë në luftë të vazhdueshme me gjykimet e shëndosha në ndërgjegjen e popullit.

Në popull ka dhe anekdota të cilat zbulojnë kontradikta në gjirin e vetë popullit, aftësi e të meta shpirtërore e morale, të cilat i gjejmë tek njerëzit e popullit.

Këto anekdota zakonisht zbulojnë e vënë në lojë komiken dhe negative «elementare», ose të meta e vese kryesisht individuale (jokarakteristike për gjithë shtresën e klasën ku bën pjesë mbartësi i tyre), si naiviteti dhe të ëndërruarit pa baza, dembelizmi dhe puna pa ndërgjegje e rregull, kokëfortësia dhe konservatorizmi, inati i kotë dhe kryelartësia, gënjeshtria e mashtrimi etj. etj.

Në anekdotat e kësaj natyre shpesh një tipar negativ gërshetohet, shoqërohet me tipare të tjera. Në këtë mënyrë pohohet se tiparet negative burojnë njëri nga tjetri dhe «plotësojnë» njëri-tjetrin, duke u bashkuar në tipa negativë e qesharakë. Simbas anekdotës, p.sh., dembelizmi dhe paaftësia për punë të rregullt karakterizojnë në radhë të parë njerëzit budallenj. Vetëm ata mund të rrinë tërë ditën pa punuar e t'i luten përëndisë për t'i nxjerrë nga situata, apo të pranojnë që të digjen e të mos lëvizin; vetëm ata punojnë pa asnjë plan, s'dinë të racionalizojnë forcën, kohën, mundësitë e tyre, ose të përfitojnë nga eksperiencia e të tjerëve. E të gjitha këto çojnë pastaj te kërkimi i rrugëve jo të ndershme për të jetuar, si gënjeshtria, mashtrimi e vjedhja.

Në kritikën që populli u bën të metave e veseve, për të cilat u bë fjalë më lart, niset nga parime e gjykime përgjithësisht të shëndosha: konsiderata ndaj punës si burim të mirash materiale dhe masë e vlerës së njeriut, pohimi se nuk duhet të sillesh me tjetrin ashtu si nuk të pëlqen të të sillet ai, se lumturia personale nuk mund të mbështetet në «kënaqësitë» e çastit që sjell një gjë e fituar pa mund e nder, se rrugët e tërthorta e të lehta për plotësimin e kërkesave materiale dhe shpirtërore janë të huaja për njerëzit e vërtetë, se është e domosdoshme mbështetja në eksperiencën dhe në mësimet e jetës dhe lufte për të ruajtur dinjitetin etj. Kështu që anekdota, duke fshikulluar negativeve e duke i kundërvënë asaj pozitiveve, pohon ekzistencën e së arësyeshme dhe morale, nxjerr në pah aftësitë dhe tiparet më të mira të masave punonjëse.

Krahas këtyre gjykimeve të drejta, në disa anekdota të së kaluarës dalin mendime jo të shëndosha, si «kush bën mirë gjen keq», ose «nga i keqi lind i keq»; duket një farë aprovimi i individualizmit dhe i egozimit. Këto mendime duhen parë si shprehje të atyre kufizimeve ideologjike të masave popullore në të kaluarën dhe të atij infiltrimi të pikëpamjeve të klasave sunduese, për të cilat u fol më lart. Këtu, mendojmë, duhen kërkuar edhe shkaqet e një qëndrimi, nganjëherë, jo të përcaktuar e të qartë ndaj këtij ose atij fenomeni e personazhi, apo shprehja e ndonjë gjykimi evaziv e të përgjithshëm. Në një anekdotë, p.sh. aprovohet ky mendim: «Po ndigjove botën, jo vetëm kambën, po edhe kokën ke me e thye».²⁹ Idetë e drejta që shpreh populli në anekdotat e tjera për mbështetjen te kolektivi i shëndoshë, shprehja se «kur s'ke shokun, pyet shkopin» etj., na bëjnë të supozojmë se këtu është fjala për nevojën e luftës për të ruajtur dinjitetin, për aftësinë që të dallohet fjala e këshilla e mikut nga ajo e armikut; por mënyra e shprehjes së mendimit që cituam lë shteg për interpretime jo të drejta lidhur me sinjeritetin dhe drejtësinë e mendimit të kolektivit në përgjithësi.

Anekdotat popullore, duke zbuluar e vënë në lojë shfaqjet negative

29) A. Çetta, *vep. e cit.*, f. 190.

në jetë, pohojnë se këto janë karakteristike për shoqëritë antagonistë, se stimulohen dhe «lulëzojnë» kryesisht në kushtet e ekzistencës së marrëdhënjeve shfrytëzuese në prodhim. Ndjekja e interesit personal, p.sh., karakteristikë e shoqërisë antagonistë, bën doktorin, me një profesion aqë human, të hidhërohet me njerëzit që nuk sëmuren;³⁰ dëshira për të harruar, goftë dhe për një çast, hallet e jetës e bën njeriun e varfër që t'i drejtohet gotës së pijes, megjithëse është i ndërgjegjshëm se «ka me u toçë sonte e nesër ka me u përdredhë ujë»;³¹ mungesa e një aktiviteti të gjallë e të organizuar kultural, banaliteti dhe amullia e jetës së përditshme, detyronin njeriun të kundërveprojë me mënyra të ndryshme, stimulonin shfaqje të tilla si dëshira e pamotivuar për t'ia hedhur tjetrit, bile dhe shokut të halleve, për t'u tallur e për të bërë shaka, shpesh jo pa dëm, në kurriz të tij etj.

Të meta e vese të ndryshme, si përpjekje për t'i dhënë shoqërisë më pak e për të marrë më shumë, puna pa ndërgjegje e rregull, veprime në kundërshtim me fjalët etj., anekdota gjen edhe në epokën tonë, veçse jo më si shfaqje me një mbështetje ekonomiko-shoqërore, jo si shfaqje të natyrshme, por si mbeturina të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve, si shfaqje dhe ndikime të huaja. Në këto raste qëndrimi kritik i anekdotës është gjithmonë i hapur dhe i prerë.

* * *

Mbartës të këtij apo atij tipari, të kësaj apo asaj ideje që kërkon të shprehë populli nëpërmjet anekdotës, janë personazhe të ndryshëm, e, meqë anekdota, ashtu si përralla, ndërtohet në bazë të kontrastit midis së mirës dhe së keqes, morales dhe imorales, logjikes dhe alogjikes, edhe personazhet e saj paraqiten si pozitivë e negativë. Populli e sheh idealin e tij te personazhi pozitiv, te njeriu aktiv, krijues, mbartës i karakteristikave tipike të masave punonjëse; ai mburret me logjikën e këtij personazhi, me zgjuarsinë, me energjinë dhe tiparet e tjera pozitive; e ngre këtë personazh në lartësinë e simbolit, të besimit në forcat e veta, të qëllimeve të tij. Personazhet negativë, në plan të gjërë moral, janë mbartës të së keqes; po të shikohet çështja në plan shoqëror, ato përfaqësojnë klasat shtypëse të së kaluarës ose elementin konservator, mbartin tiparet, botëkuptimin dhe ideologjinë e klasave armike të masave punonjëse. Prandaj këto personazhe paraqiten në anekdotë jo vetëm si qesharakë e të ulët, por edhe të dëmshëm për shoqërinë.

Zakonisht personazhet e një anekdote, pavarësisht se me çfarë emri, pavarësisht nëse ka apo jo një emër të përveçëm, e gjejmë edhe në anekdota të tjera, ku spikat, në situata të ndryshme, i njëjti tipar, ose tipare të tjera karakteristike për klasën, shtresën e grupin shoqëror që ai përfaqëson. Në këtë kuptim mund të flasim për tipa të ndryshëm në anekdotat.

Në anekdotën tonë, si një nga përfaqësuesit më tipikë të klasave sunduese të së kaluarës, del dhe beu. Në figurën e tij anekdota ka mishëruar gati të gjitha anët thellësisht negative, reaksionare dhe antinjerëzore të klasës feudale.

Karakteristikë kryesore e beut është etja e pashuar për pasuri. Kjo e bën atë që të jetë një shtypës e shfrytëzues jashtëzakonisht i egër dhe brutal. Ai i rrëmben tokën pa gjë të keqe fshatarit, e rjep atë me cinizëm

30) AIF, GjSh, fl. 2/2, f. 201.

31) AIF, GjSh, fl. 1, f. 38.

nëpërmjet punës së rëndë, taksave të ndryshme, angarive e ryshfeteve. Duke qenë në pozita të privilegjuara, merr nëpër këmbë kur të dojë e si të dojë dinjitetin e bujkut, argatit apo hyzmeqarit të vet, nëpërmjet kamxhikut, sharjeve nga më të ndyrat, kërkesës që t'i drejtohen me temena etj. Duke jetuar në plogështi, në mënyrë parazitare, beu nuk di, ose, më mirë, nuk do t'ja dijë sa e vështirë është puna; duke jetuar në bollëk, nuk di ç'është nevoja, mundimi dhe dhembja e skamjes. Të gjitha këto përjashtojnë nga personi i tij çdo gjë humane, çdo mëshirë për të munduarit. Ai, p.sh., jo vetëm që s'i qan hallin njeriut që punon për të, jo vetëm që e kthen gjithnjë duarbosh fshatarin që i kërkon hua ndonjë okë misër për fëmijët e uritur, por, edhe kur e lajmërojnë për vdekjen e hyzmeqarit, përgjigjet me cinizëm: «O, hajvani! Ku e gjeti tani në vakt të punës!»³² Etja për pasuri e bën beun të jetë edhe kurnac jashtë mase, të ankohet vazhdimisht, se i hanë shumë bukë argatët e të kufizojë në maksimum ushqimin e tyre por, kur është puna për nam, ai i harxhon paratë pa kursim. Jeta e shturur e pa një qëllim të lartë e fisnik, imoraliteti, sjelljet anadollake e trashamane, gënjeshtria dhe kryelartësia, injoranca, fanatizmi fetar dhe konservatorizmi janë gjithashtu tipare karakteristike të beut. Si njeri politik ai është mbrojtës i flakët i regjimeve thellësisht antipopullore, i çdo gjëje reaksionare; ai s'ka asnjë ndenjë patriotike e kombëtare, por është i gatshëm të bashkëpunojë me çdo pushtues për interesat e veta, kundër popullit dhe atdheut. Prandaj beun e gjejmë si zyrtar të lartë në kohën e Turqisë, si deputet etj. në kohën e Zogut, si bashkëpunëtor të pushtuesve të huaj.

Në këtë mënyrë anekdota, duke fshikulluar këtë apo atë bej, sulmon klasën e tij, shfrytëzuesin në përgjithësi.

Në anekdotat dalin edhe një varg përfaqësuesish të administratës shtetërore të regjimeve antipopullore, si mbreti, veziri, vali, kadiu e zabiti turk, deputeti, qeveritari, nëpunësi e oficeri zogollian etj. Karakteristika të përbashkëta të tyre janë egoizmi, parazitizmi i plotë, shtypja dhe shfrytëzimi i masave popullore, esenca reaksionare, konservatore dhe antipopullore e pikëpamjeve dhe e veprimeve të tyre. Le të marrim, fjala vjen, kadiun, si autoritet laik e fetar, si «njeri i ligjit».

Tipari karakteristik i kadiut është ndjekja sistematike e interesit personal dhe, në pajtim me këtë, mungesa e plotë e parimeve. Ai e vërtit ligjin si të dojë, e kthen fjalën pakurrfarë hezitimi a turpi, merr këtë apo atë vendim jo simbas ligjit, por simbas personit që gjykon, ose simbas interesit. Atij i pëlqen shumë ryshfeti dhe për hir të tij është gati të bëjë çdo dallaver, çdo bataqillëk e çdo kompromis. Në të njëjtën kohë ai është edhe imoral, edhe gënjeshtar, edhe injorant. Këto e vënë shpesh në pozita nga më qesharake dhe e bëjnë një personazh të urryer. Kështu, p.sh., ndërsa pohon pa hezitim se gruaja «s'duhet ndigjue kurrë», kur merr vesh se është fjala për një qyp mjaltë e një teneqe djathë që një grua propozon t'i dhurohen atij, hap qytapin dhe «zbulon» një nen ku thuhet se «edhe gruaja duhet ndigjue njëherë në katërdhet vjet»;³³ ndërsa e di fare mirë se me anën e kujt është e drejta, e nxjerr fajtorin të larë, sepse për këtë paskish pasë «95 shahitë»³⁴, dmth. 95 florinj etj.

Një tjetër personazh negativ, që, bashkë me dhespotin, hoxhën, ba-

32) AIF, JP (Jorgo Panajoti), v. 14, f. 159.

33) J.U. Jarnik, MHFSH-I, f. 354.

34) AIF, ZS (Zihni Sako), fl. 1, f. 17.

banë e teqesë etj., përfaqëson në anekdotat klerikun, është prifti. Ky është po aq shtypës e shfrytëzues sa beu, po aq interesaxhi sa kadiu, por më cinik e më dhelparak: në vend të kërbaçit përdor kryqin, në vend të kodit përdor ungjillin e në vend të fjalës brutale fjalën hipokrite, të mbuluar me tymin e temjanicës. Ai e heq veten si përfaqësues të zotit në tokë, si moralist, që predikon «fjalën e zotit»; por dhe vetë nuk beson në ato që thotë, vepron në kundërshtim me ato që thotë, nuk çan kokën fare për «porositë e zotit» e në çdo hap shkel pa skrupull dhe normat më elementare të moralit të shëndoshë. Kështu, p.sh. prifti e mundon aq shumë shërbëtorin, saqë ky detyrohet të largohet e, kur gjen ca njerëz që donin të mbysnin një qen, u propozon ta dërgojnë shërbëtor te prifti, se atje ka për të hequr më shumë³⁵; mbarësinë e vitit e gjykon nga sasia e njerëzve që ka varrosur, dmth nga mundësia për të fituar para³⁶; predikon ndihmën ndaj të afërmit, por kur merr vesh se priftëresha, duke zbatuar porositë e tij, i jep një të varfëri një këmishë, revoltohet dhe e sqaron se fjalët që tha në kishë ishin vetëm për të tjerët;³⁷ ai i kryen shkel e shko shërbesat fetare, qoftë se e ka të qartë kotësinë e tyre, qoftë nga dembelizmi i madh që e karakterizon, qoftë nga injoranca. Në të njëjtën kohë ai paraqitet dhe si pijanik i madh, hamës e imoral dhe shpesh bie në pozitat e dashnorit të zënë ngushtë, që është gati të futet në çdo vrimë, të pranojë çdo poshtërim, vetëm e vetëm që turpin e tij mos ta marrë vesh askush.

Një personazh mjaft i përhapur në anekdotat tona, është shërbëtori. Ai është njeri i popullit, i vuajtur dhe i varfër, që, duke mos pasur mjete të tjera jetese, detyrohet të bëhet skllav i zotërisë, të kryejë punë nga më të rëndat e nga më poshtërueset që të nxjerrë kafshatën e gojës. Zotëria e shikon atë si vegël a kafshë të thjeshtë pune, e ngarkon me detyra nga më të ndryshmet, gjen mënyra nga më dinaket për ta munduar e shfaq dëshira nga më qesharaket, siç është dëshira që dhinë e tij të kthehen nga kullota duke qeshur e duke kënduar, që mushka e tij të mësojë shkrim e këndim etj. Dhe për çdo mossukses ose mosmbarëvajtje të punës së zotërisë është shërbëtori ai që akuzohet si shkaktar. Ja pse Nastradini, p.sh., mendon se është më mirë të merresh me pastrimin e ndyrësirave sesa të jesh shërbëtor i beut.³⁸

Në këto rrethana, edhe shërbëtori detyrohet të kundërsulmojë, duke përdorur mjete të ndryshme, sidomos zgjuarsinë e dinakërinë, shigjetën e mprehtë të satirës, talljen e të qeshurën e vet therrëse dhe, atje ku ka mundësi, edhe forcën, dhunën. Kështu, ai dëmton pasurinë e zotërisë, saboton kryerjen e kësaj apo të asaj pune, punon me ndërgegjen e njeriut që e di mirë se s'ka asnjë përfitim nga puna që bën, ja hedh zotërisë me mënyra të ndryshme, duke shfrytëzuar me shkathtësi dobësitë e tij, kapriçiot, kokëtrashësinë. Këto veprime nuk janë diçka krejt individuale, por pasojë e ligjshme e kushteve në të cilat jetonte shërbëtori, janë shprehje e urrejtjes së tij ndaj shfrytëzuesit, shprehje e rezistencës dhe e luftës së tij kundër shtypjes, përpjekjes për të jetuar në një farë mënyre.

Duhet thënë gjithashtu se, nëse zgjuarsia e shërbëtorit del në anekdotat si tipar i njeriut të popullit në përgjithësi, hipokrizia në marrëdhënjet e tij me zotërinë e si karakteristikë e veçantë e këtij tipi shoqë-

35) Po aty, f. 23.

36) AIF, JP, v. 14, f. 112.

37) AIF, ZS, fl. 1, f. 31.

38) AIF, KH (Keti Harito), fl. 17, f. 34.

ror, kushtëzohet nga rrethanat në të cilat ai jetonte. Lidhur me këtë Lenini shkruante se «këtu puna qëndron pikërisht te tipi social dhe jo te vetitë e njerëzve të veçantë. Shërbëtori mund të jetë njeri shumë i ndershëm, pjesëtar shembullor i familjes së tij, qytetar shumë i mirë, por ai patjetër është i dënuar të bëjë hipokrizi sepse tipari kryesor i profesionit të tij është bashkimi i interesave të zotnisë, të cilit ai «i është zotuar» t'i shërbejë «me besa-besën» me interesat e rrethit, nga i cili rekrutohen shërbëtorët.»³⁹

Në anekdotat e reja popullore — ato të periudhës së Luftës nacionalçlirimtare dhe të pasçlirimit — dalin figura të reja. Një nga këto figura është ajo e ballistit. Si ballistë në anekdotat dalin përfaqësues të klasave sunduese të së kaluarës dhe elementë të degjeneruar (shpesh ata jepen me emër: Ali Këlcyra, Hasim Xhindolli etj.), por nganjëherë edhe njerëz të gënjyer, të cilët, mbasi shohin me sytë e tyre tradhëtinë e Ballit, largohen andej.

Anekdotat zbulon fytyrën e vërtetë të ballistit si bashkëpunëtor i pushtuesve nazifashistë, si armik i popullit. Përpjekjet e tij për t'u mbushur mendjen njerëzve se lufton për Shqipëri, se ka një farë ideali etj., kthehen në qesharake, sepse ai jo vetëm që djeg, vret e grabit njësoj si pushtuesi, por, kur është puna për luftë të vërtetë kundër zaptuesve, pushka e tij kthehet në një ornament të thjeshtë kapardisjeje, ose, siç shprehet populli, në një «mashë pas krahu». Ja pse populli pranonte t'i quante ata meshkuj e jo burra⁴⁰, bisht e jo ball.

Anekdotat, nëpërmjet episodeve të ndryshme, vë në dukje edhe karakteristika të tjera të ballistit, si mungesa e karakterit, rendja pas pjaçkës, dëshira për të jetuar në mënyrë të shthurur në kurriz të popullit, harbutllëku, frika e madhe prej partizanëve etj.

Në anekdotat ka disa personazhe humoristike, që vihen në qendër të subjekteve të ndryshme anekdotike dhe njihen me një emër të caktuar të përveçëm. Këto personazhe mund të jenë të krijuara, apo të kenë prototipin e tyre historik, real; veçse popullit nuk i intereson vërtetësia e tyre, por komizmi i veprimeve dhe i sjelljeve të tyre, idetë dhe tiparet që mbartin, prandaj nuk nguron të krijojë rreth tyre edhe subjekte të reja e t'u atribuojë veprime të të tjerëve. Kështuqë këto personazhe kanë fituar një karakter me të vërtetë anekdotik.

Mund të themi se çdo krahinë, nganjëherë dhe çdo qytet e fshat, ka personazhet e veta humoristike. Në Shkodër, p.sh., veç të tjerëve, si i tillë njihet Osja i Falltores e Pashkja Fyttagac, në Myzeqe Cane Rukja, në Përmet Lalë Gjoni e Stamo Dumua, në Skrapar Muha Çolla, tek arbëreshët e Italisë Xhuhai, në Drenicë të Kosovës Dervish Goxhuli dhe Xhemajl Obrija etj. Prej këtyre shumica dalin si njerëz të popullit, me një përvojë të madhe nga jeta, me ndjenjën e humorit të zhvilluar e me mendje të mprehtë e të shëndoshë; por, me gjithë afëritë e tiparet e për-bashkëta, megjithëse koha i ka zbutur shumë dallimet midis tyre, ata përfaqësojnë dhe mbartin mendime të shtresave dhe klasave të ndryshme që përbënin popullin në këtë ose atë epokë, kanë secili diçka origjinale, diçka si profil të veçantë. Osja i Falltores p.sh. (Oso Mani), që jetoi në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar në Shkodër (1842-1902) e që ka qenë shumë i varfër e merrej me lloj-lloj pune për të nxjerrë kafshatën e gojës, njihet si njeri i mprehtë, shakaxhi, bejtexhi satirik dhe ahengçi, që herë

39) *Lenini për kulturën e artin*, Tiranë 1960, f. 11.

40) AIF, MZ, fl. 15, f. 25.

duke u shtirë si naiv e herë me talljen e tij të hapur, vinte në lojë të metat dhe veset e njerëzve⁴¹; për Cane Rykën (ose Ryçon) e Myzeqesë nuk mund të thuhet me saktësi se kur jetoi (e sjellin nga fundi i shekullit XIX, fillimi i shekullit XX), por dihet se ka qenë nga Mbyeti i Fierit, njeri i varfër dhe shakaxhi i përmendur, që i pëlqente sidomos të vinte në lojë bejlerët dhe agallarët⁴²; Dervish Goxhuli ishte një fshatar i varfër nga Makërmali i Drenicës, që jetoi në vitet 1870-1938 dhe bëri emër me shakatë e tij të holla, me thumbimet e hidhura që u bënte pasanikëve dhe njerëzve me vese, me gjykimet e tij të mprehta dhe me këngët që ngrinte vetë⁴³; kurse Xhuhai i arbëreshëve (ose giuha dhe xhufa), tip i njeriut «sherbudalla»,⁴⁴ mund të ketë lidhje me prototipin arab të Nastradin Hoxhës, komikun dhe dinakun homonim, për të cilin, simbas bibliografit An-Nadin të shekullit X, ka pasë ekzistuar një përmbledhje anekdotash.⁴⁵

Veç këtyre personazheve, të themi, lokalë, krahinorë ka edhe personazhe — Nastradin Hoxha, Qerozi, vëllezërit Tosko e Mosko (Tosthi e Boshti, Toçi e Poçi) etj. — që njihen në të gjithë Shqipërinë. Pa dyshim, midis këtyre personazheve, ai që ka fituar më shumë popullaritet është Nastradin Hoxha.

Nastradini, që njihet në shumë popuj të tjerë (që nga ujugurët në Kinë e deri në Spanjë), është një personazh me origjinë orientale. Ky fakt pohohet dhe në anekdotat tona. Ndonjë anekdotë, p.sh., fillon me shprehjen: »Kur erdhi Nastradini tek ne...»; ndonjë tjetër tregon se Nastradini erdhi vetëm deri te Qafa e Thanës dhe u kthye prapë përnga lindja, mbasi u zu në fjalë prej një çobani të zgjuar:⁴⁶ një tjetër akoma pohon se ai paskish vajtur dhe në Shkodër dhe u zu në fjalë prej dy fëmijësh «të pahejra»⁴⁷. Por, ndërsa origjina e tij orientale pranohet thuajse nga të gjithë, diskutimet më të mëdha janë bërë e po bëhen rreth vërtetësisë së tij historike, dmth. a është mit Nastradini, apo me të vërtetë ka jetuar dikur në botë. Kjo është çështja kryesore e të ashtuquajturit «problem i Nastradin Hoxhës». Disa pranojnë si të sigurtë qenjen e tij si person historik, por prapë diskutohet, bile në mënyrë të tepruar, çështja e vendosjes së tij në një rajon të caktuar, në një datë kronologjike, si dhe afrimi i tij me një prototip të caktuar historik. Simbas tezave të ndryshme, p.sh., Nastradini duhet të ketë jetuar në shekullin VIII ose XII, XIII-XV, apo XVII. Kohët e fundit, duke u bazuar në të dhëna të ndryshme, sidomos në kërkimet e profesorit të Universitetit të Stambollit Mehmet Fuad Kyprilzade, sikur pranohet se Nastradini ka jetuar në shekullin XIII (në periudhën mongole) dhe vdiq në Akshehir të Azisë së Vogël⁴⁸. Disa stu-

41) Për të dhëna biografike rreth tij shih AIF, GjSh, fl. 1, f. 7.

42) AIF, JP, fl. 14, f. 7.

43) A. Cetta, *vep. e cit.*, f. 252,

44) MHFSH-III, f. 543, 570.

45) *Anekdoty ob Hodzhe Nasredine*, Moskë 1957, f. 5.

46) AIF, JP, fl. 14, f. 165.

47) AIF, GjSh, fl. 13/1, f. 42.

48) Simbas profesorit turk, këtu u gjet varri i një Nastradin Hoxhe, në pllakën e të cilit është shënuar data 386 i «Hixhrit», dmth. 993. Kjo datë është parë si e pranueshme, sepse shëlxhukët, me epokën e të cilëve lidhet emri i Nastradinit, u dukën në Azinë e vogël vetëm në gjysmën e dytë të shek. XI; prandaj më vonë, u supozua se data duhet lexuar në mënyrë komike, së prapthi, dmth 683 (1284-1285). Shfaqja e Nastradinit edhe në kohën e Timurit (shek. XIV) është konsideruar si vepër e fantazisë popullore (pashënie e VI. Gordlevskit në *Anekdoty ob Hodzhe Nasredine*, f. 247-248).

Siç shihet, këtu kemi të bëjmë me hipoteza që nuk mund të vërtetohen dhe që qëndrojnë në këtë mënyrë, mbi baza shumë të lëkundshme.

djues të tjerë kundërshtojnë me bindje çdo arësyetim për një Nastradin historik. Sidoqoftë, edhe sikur të pranojmë se dikur e diku ka jetuar me të vërtetë një Nastradin Hoxha, është fakt se gjatë shekujve figura e tij historike është zbehur shumë; tek ajo s'ka mbetur thujasë asgjë historike, veç disa thënjeve me karakter legjendar, që shpesh kundërshtojnë njëra-tjetrën. Kështuqë figura e sotme e Nastradinit, e përpunuar dhe e pasuruar nëpërmjet rrugëve të ndryshme, u është përshtatur kushteve të veçanta të popujve, midis të cilëve ka jetuar e vepruar. Ja pse cikli i anekdotave rreth Nastradinit, veç disa linjave të përbashkëta, ndryshon nga vendi në vend. Në këto rrethana besojmë se s'janë aq frytdhënëse e të rëndësishme përpjekjet për të gjetur prototipin historik të Nastradinit, sesa studimi i karakterit shoqëror dhe i ideve të kësaj figure, ashtu siç paraqitet ajo në anekdotat e këtij apo të atij populli.

Për popullin tonë Nastradini ka qënë një njeri i urtë, i mençur e fjalëmprehtë, që fliste me masat popullore me një gjuhë origjinale, të thjeshtë e komunikuese. Ai jetoi në një vend e në një kohë të papërcaktuar: herë na del si bashkëkohës i Timurit e herë si bashkëkohës i Bushatllinjve të Shkodrës. Në një anekdotë tregohet se pyetjeve të mbretit «Kush je ti? Ku ke lindë? Kur ke lindë? Kush janë të parët e të mbramit e tu?», Nastradini u përgjigjet në këtë mënyrë: »Jam një njeri; kam lindë në këtë botë!; kam lindë ku më ka ba nana; të parët e mij janë baba e nana, të mbramit janë fëmijët». ⁴⁹ Kjo do të thotë se për popullin figura e Nastradinit s'njeh kufi, as në kohë e as në hapësirë. Nastradini mund të vendoset (dhe është vendosur) në kohë e vende të ndryshme, në këtë apo atë situatë, mjafton që në të gjitha këto raste të veprojë e të flasë në mënyrën e vet karakteristike. Prandaj, ndonjëherë, veprime e fjalë të personazheve të tjerë i atribuohen Nastradinit; ndonjëherë ai zëvendëson personazhe të njohura të përrallavet tona humoristike (Marashin, Kacjin, Musën e vogël), duke u vënë në garë zgjuarsie me qoset, mbretin etj.. bile edhe me qenje të tilla fantastike si dragojt, djemtë e kuçedrës, divat, kreshnikët e katallanët. ⁵⁰

Nastradini del në anekdotat tona kryesisht si hero popullor, si njeri i popullit. Ai është i varfër, jeton në mënyrë të thjeshtë, shpesh »bie ngushtë për para«. Bën punë nga më të ndryshmet, si zanatçi i lirë, druvar, bujk, qymyrxhi, shërbëtor etj., etj.. Kjo e lejon atë që të hyjë në marrëdhënje me njerëz të ndryshëm, të bjerë në kontakt direkt me jetën e përditshme. Nga ana tjetër, zgjuarsia e tij e lejon që t'i njohë shumë mirë si njerëzit ashtu dhe jetën, si hallet e popullit ashtu dhe mediokritetin, egërsinë, imoralitetin dhe parazitizmin e klasave shfrytëzuese. Për këtë na bindin fjalët dhe veprimet e tij, buzëqeshja e tij ironike dhe tërë mëndjemprehtësi, megjithëse bën sikur s'kupton asgjë, sikur s'çmon asgjë.

Pozita e tij shoqërore dhe eksperiencia jetësore e bëjnë atë që të dalë si mbrojtës i njeriut të thjeshtë, si mbrojtës i së drejtës dhe i së arësyeshmes e të vihet kundër «të mëdhenjve të botës». Kështu, nga njëra anë mbron të varfërin në këtë apo atë gjyq, nga ana tjetër sulmon, tall e ja hedh mburravecit mendjetrashë, interesaxhiut, pasanikut të egër e mediokër, gjykatësit rryshfetçi e dritë-shkurtër, përfaqësuesit të administratës së rendeve antipopullore, klerikut bile dhe vetë zotit dhe vdekjes (le të

49) AIF, Gj.Sh., fl. 3, f. 265,

50) AIF, Tefë Kuqani fl. 2, f. 43 dhe 96, P. Gjidede, fl. 46 përr. nr: 5, A. Çetta, *rep. e cit.* f. 248 etj.

kujtojmë sesi Nastradini, pasi i merr fjalën Shën Mëhillit që ta lejojë të lutet para se t'i marrë shpirtin, e lë atë të presë duke e zgjatur lutjen aq shumë sa që kryeëngjëlli detyrohet të largohet⁵¹.

Nganjëherë në anekdotat tona Nastradini del në rolin e kadiut rryshfetçi, të mashtruesit ordiner, që ua hedh të varfërve ose budallenjve, bile edhe në rolin e budallait. Kjo gjë, që vihet re edhe në anekdotat e popujve të tjerë për Nastradinin, i jep figurës së tij atë karakter kontraktaktor, për të cilin janë bërë diskutime të gjata. Ky karakter zakonisht është shpjeguar me sinkretizmin në folklor, i cili, midis të tjerave, lejon bashkekzistencën e mendimeve krejt të kundërta tek i njëjti person. Në të vërtetë shkaqet janë më të shumta dhe, ndonjë, më i rëndësishëm se sa ky. Së pari, duhet të themi se Nastradini shpesh, pas formës komike, si prej budallai, të veprimit ose të fjalës së vet, fsheh një ide të mprehtë, pozitive. Në një anekdotë, p.sh. tregohet se ai ju lut shumë perëndisë për t'i gjetur gomarin e humbur, por, edhe pasi lutjet e tij nuk nxorrën gjë, prapë u ul në gjunjë e filloi t'i falet nderit perëndisë; dhe kur e pyetën pse e bënte këtë gjë, ndërsa perëndia s'ja plotësoi dëshirën, Nastradini u përgjeggj: «I falem nderit perëndisë që s'u ndodha dhe unë majë gomarit, se do të kisha humbur bashkë me të».⁵² Me këto fjalë si pa kuptim Nastradini në të vërtetë tallet me besimin të ndihma e zotit. Dhe, kur është puna për diçka pa mend, ai nuk nguron të vërë në lojë këdo, bile edhe vetveten. Së dyti, Nastradini shpesh shtiret si i tillë apo i këtillë me qëllim që, nëpërmjet shembullit konkret, të vërë në lojë anë të ndryshme negative, t'u japë mësimë instruktive njerëzve, dmth. kalon vullnetarisht në pozitë e aktorit me kuptimin e vërtetë të fjalës. Në këto raste ai interpreton këtë apo atë rol, më saktë, parodizon, fjala vjen, kadiun rryshfetçi, kapriçiozin, budallanë etj. Prandaj duhet dalluar mirë Nastradini si autor nga Nastradini si aktor. Më në fund, dihet se, gjatë procesit të rritjes së ciklit të anekdotave rreth Nastradinit, këtij i janë atribuar veprime e fjalë të personazheve të tjera anekdotike. Nënkuptohej se në këtë rasi klasat sunduese të së kaluarës e kleri reaksionar kanë futur elemente të ideologjisë, botëkuptimit dhe mënyrës së tyre të jetesës.

Në popullin tonë ka dhe anekdota «subjekti» i të cilave lidhet me një person të caktuar historik. Këto anekdota në fakt janë detaje historike, fragmente nga jeta individuale shoqërore e politike e personave historikë dhe japin të dhëna interesante për karakterin e tyre si njerëz, për idetë dhe pikëpamjet e tyre, për veprimtarinë e tyre dhe për karakterin e procesit historik të epokës së tyre. Në këto anekdota flitet, p.sh., për Skënderbeun, si udhëheqës i madh, i lidhur ngushtë me popullin e që drejton luftën e tij kundër dyndjes otomane,⁵³ për Ali Pashën, si njeri i zgjuar, që çmonte punën etj., por edhe si despot⁵⁴; për Luigj Gurakuqin, si kundërshtar i politikës zogolliane, si antifeudal e patriot i ndershëm⁵⁵ etj.

* * *

Përmbajtja dhe personazhet e anekdotave, për të cilat u fol më lart, dëshmojnë për lidhjen e ngushtë e në mënyrë organike të këtyre krijime-

51) Pohimi se Nastradini «u diftue... i shtruem vullnësës së zotit» (*Leka*, 2/1936, f. 120) është një shtrembërim i së vërtetës, i fakteve dhe duhet konsideruar si «kontribut» i klerit reaksionar shqiptar në përpjekjet e klerit të vendeve të tjera, për ta paraqitur këtë figurë si predikues «të fjalës së zotit», të pajtimit me situatën etj.

52) *Leka*, 2/1936, f. 122.

53) *Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun*, T. 1968, f. 104, 110, 189 etj.

54) *Hosteni*, 5/1959, f. 11, 11/1962; f. 8; AIF, F.M. Rrapaj, fl. 1, f. 26, 29, 120 etj.

55) AIF, Gj.Sh., fl. 13/1, f. 135, fl. 16. f. 303 etj.

ve me jetën, me problemet e kohës, me ambjentin dhe kushtet shoqërore. Kjo i jep anekdotës atë karakter realist, që e dallon nga llojet e tjera të tregimit folklorik. Sigurisht ne mund të flasim për realizëm⁵⁶ edhe në llojet e tjera të tregimit folklorik, p.sh. në përrallat realiste-satirike, në fabulat etj. Elemente të realitetit ka gjithashtu edhe te përrallat fantastike e te legjendat; por, realizmi i anekdotës është, si të thuash, më i pastër, më i pamëshirshëm, më i qartë. Heroi i anekdotës, fjala vjen, është më real, më i kapshëm, më i afërt. Si i tillë te anekdota nuk është djali-gjarpër, as djali-dragua, por fshatari, argati, shërbëtori. Dhe ky lufton jo kundër shtrigës e kuçedrës, por kundër beut, agait, zotërisë, priftit. Ai fiton mbi armiqtë e vet jo me ndihmën e shpatës magjike e të kalit të mrekullueshëm, por me zgjuarsinë, me shkathtësinë, me dinakërinë e vet. Gjithashtu hero i anekdotës jeton e vepron në një ambjent real, p.sh. në ambjentin e njohur fshatarak të paraçlirimit. Nga ana tjetër, anekdota i përshkruan shfaqjet e ndryshme të jetës jo në mënyrë të tërthortë e relative, por në mënyrë të drejtpërdrejtë, imediate, pa u drejtuar te alegoria e te simbolizmi i fabulës.

Realizmi i anekdotës është më i dukshëm në ato raste kur «subjektin» e saj e përbëjnë detaje e fakte nga jeta e personaliteteve historike dhe e njerëzve realë.

Ja pse Gorki shkruante: «Në rast se anekdota është e mprehtë, e zburkuron historinë ashtu siç stolis miniatura artistike një fletë analesh».⁵⁷ Gjithashtu tek anekdotat gjejmë shfaqje të zakonshme, të përditshme, hollësi reale, pa përjashtuar dhe momentet e ashpra e të shëmtuara, që lidhen me qëllime e motive nga më të ndryshmet të njerëzve; në to gjejmë dhe «pejsazhe», emra vendesh e njerëzish, fragmente nga mënyra e veçantë e jetës materiale e shoqërore që i përkasin kësaj apo asaj krahi-ne, dmth. gjithshka që e quajmë kolorit lokal. Në këtë mënyrë bota e anekdotës është vetë realiteti. Forma e saj e lëvizshme, syri i mprehtë, aftësia për të parë thellë e për të zbuluar gjëra interesante i japin asaj mundësi që të transmetojë nuanca, ndjenja dhe pamje nga më të ndryshmet.

Lidhja e anekdotës me një fakt real nuk mund të na çojë në konkluzionin se kemi të bëjmë me krijime natyraliste apo me «instantané fotografike», siç e kanë paraqitur çështjen disa. Anekdota nuk është fotografim i thjeshtë, riprodhim mekanik i realitetit, por dhe përpunim artistik i tij; ajo nuk i paraqet rastësisht hollësitë dhe faktet reale të jetës, por me qëllime të caktuara ideo-estetike, për të shprehur gjykime e për të bërë përgjithësime. Prandaj jo çdo fakt mund të shërbejë si bazë për ndërtimin e anekdotës. Populli, zakonisht, midis fakteve të shumta reale, zgjedh ato që janë më tipike, më të përgjithshme, që shërbejnë më mirë për të shprehur këtë apo atë mendim e ide. Pastaj, nëse çdo anekdotë e marrë në veçanti, duke qenë e lidhur me një fakt të vetëm, s'mund të pretendojë për tipizim e përgjithësim të thellë, një cikël i tërë anekdotash, ku secila lidhet në mënyrë organike rreth të njëjtit problem a personazh, duke zbuluar anë e tipare të reja të tyre, ja arrin këtë qëllimi. Dhe kur fakti real nuk mjafton për të bërë përgjithësim, atëhere ndërhyjnë trillimi poetik, fantazia. Veçse, ashtu si realizmi, edhe tipizimi, edhe trillimi anekdotik kanë karakteristikat e tyre të veçanta, realizohen nëpërmjet rrugësh

56) Jo me kuptimin e metodës.

57) Shif *Russkaja etnografija*, 4/1953. f. 6.

e mjetesh specifike, që varen nga përmbajtja e veçantë dhe nga cilësitë e objektit të pasqyrimin të anekdotës.

Objekt i pasqyrimin të anekdotës është komikja. Gjithmonë ajo, duke riprodhuar artistikisht realitetin, u kushton më shumë vëmendje anëve dhe aspekteve që kanë karakter komik. Në këtë kuptim mund të themi se pasqyrimi anekdotik ka karakter të njëanshëm.

Thelbi komik zakonisht është i fshehur dhe nuk vihet re lehtë. Nuk është lehtë, fjala vjen, të zbulohet kontradikta midis esencës reaksionare të moralit fetar dhe formës humane, hyjnore dhe mistike të paraqitjes së tij. Por arti i anekdotës qëndron pikërisht tek aftësia për të zbuluar thelbin komik, për të dhënë fakte e situata tipike komike. Për t'ja arritur këtij qëllimi anekdota përdor rrugë e mjete të ndryshme.

Një nga këto rrugë është të kapurit dhe paraqitja e detajeve, fakteve dhe situatave reale në çastet që shprehin esencën e tyre, anën e tyre tipike, në çaste që bëjnë përshtypje, në momente kur kontradikta është e mprehtë dhe zbulon vetvetiu komizmin e saj. Kjo bën shumë efekt dhe tërheq dëgjuesin në shtjellimin e ngjarjeve, duke i ngacmuar imagjinatën dhe kuriozitetin.

Kur nuk del qartë esenca komike e tipit apo e shfaqjes jetësore, atëherë ndiqet rruga e mprehjes, dmth. çdo figurë e çdo detal çohet deri në mprehjen maksimale të shprehjes së tij, në formën e asaj që ka ngjarë ose mund të ngjasë në jetë. Injoranca e beut, p.sh., dhe mendjengushtësia e tij shkon gjer atje, saqë ky e merr bufin për zog të shënjtë⁵⁸. Mprehja bën që në anekdotë negativja dhe pozitivja të kundërvihen në mënyrë të prerë, si të thuash, në formë klasike. Kështu, personazhi negativ s'ka asgjë të mirë; veç anëve negative të përgjithshme, ai nuk zbulon anë të tjera të botës së tij shpirtërore individuale, kontradiktat e tij të brendshme etj., që do ta bënë të dallohej nga personazhet e të njëjtit tip. Të gjitha këto tregojnë se në anekdotat tipizimi nuk arrihet aq me anën e individualizimit, por, kryesisht, me anën e përgjithësimit. Ja pse shpesh personazhet e anekdotës nuk kanë emër, ose, kur e kanë, mund të zëvendësohet fare lehtë me një emër tjetër.

Karakter i përgjithësues dhe përmbajtja plastike i japin anekdotës mundësinë që të lëvizë lirisht nga një krahinë në tjetrën e nga një vend në tjetrin; por, nga ana tjetër, lidhja e ngushtë me kushtet reale, me problemet e kohës i japin asaj një karakter të theksuar lokal e kombëtar. Karakteri kombëtar i anekdotës sonë është më i dukshëm, fjala vjen, se ai i përrallës fantastike apo i fabulës; një përqindje më e madhe anekdotash, në krahasim me llojet e përrallave që përmendëm, janë thjesht shqiptare.

Me qëllim që të zbulohet në mënyrë më të mprehtë esenca komike, shpesh përdoret jo e zakonshmja, e rralla, e papritura; por edhe në këto raste lëvizja bëhet brenda kufijve të realitetit, brenda kufijve të ngjases apo të mundësisë. Rastësisht p.sh. fshatarit i lind ideja që t'ia hedhë beut duke i shitur bufin për zog të shënjtë, por kjo rastisje mund të ndodhë vetëm në kushtet e marrëdhënjeve shfrytëzuese. Si e papritur, duket, p.sh., përgjigja e beut — «Oh, ç'na bëri hajvani!» — kur mëson vdekjen e lopçarit⁵⁹, por kjo nuk është diçka e pamundur për shfrytëzuesin e egër dhe brutal të së kaluarës.

58) AIF, JP, v. 14, f. 146.

59) Po aty, f. 159.

Mprehja, pra, bazohet në jetën reale dhe paraqitet si zgjedhje e përpiktë faktesh, tipizimi i të cilëve ka interes të veçantë.

Në raste të tjera zbulimi i komikes bëhet duke shkelur me guxim harmoninë dhe proporcionet reale, jetësore, duke kaluar kufijtë e ngjasës, nëpërmjet ekscentrizmit⁶⁰ dhe ekzagjerimit, që shprehen në formën e hiperbolës, groteskut, karikaturës etj. Në këtë rast trillimi është i dukshëm. Por ky trillim i anekdotës përdoret me çlësinë e mjetit artistik, me qëllim që të arrihet një forcë e veçantë shprehëse e të zbulohet më mirë komikja, ose për të theksuar atë që është tipike. Nëse, fjala vjen, është vështirë të pranohet se prifti mund të arrijë gjer atje sa të lejojë ta lidhin në djep, t'i shkulin mjekrrën e dhëmbët që të mos i dalë në shesh turpi, imoraliteti i klerikut mbetet fakt i pakundërshtueshëm, fakt tipik.

Ndonjëherë trillimi anekdotik shprehet edhe në formën e fantastikës. Kështu, në ndonjë anekdotë, del shejtani që tërheq prej hunde naivin⁶¹ ose vihet në garë zgjuarsie me gruan dinake;⁶² engjëlli që tallet prej Nastradinit etj. Edhe këto raste, që janë shumë të rralla, përdoren nga anekdota për të rritur peshën specifike të idesë së saj e për të bërë përgjithësime shumë të gjëra. Pra, s'kemi të bëjmë me atë fantastikën e përrallës së mirëfilltë, që buron kryesisht nga besimi në të mbinatyrshmen.

Pikësynimi i anekdotës — zbulimi i komikes, zbulimi i qesharakes, i negatives dhe kundërvënja asaj i pozitives — i jep asaj atë karakterin e theksuar kritik, dëshirën për të thumbar, për të vënë në lojë, për të tallur. Si mjete të talljes anekdotike mund të përmendim humorin, ironinë dhe sarkazmën.

Humori i anekdotës lidhet kryesisht me atë që është quajtur «komike elementare», ose me kontradiktën gjatë zhvillimit të së resë. Zakonisht ai buron nga vetë situata që paraqitet në anekdotë. Treguesi shtiret sikur nuk shënon në ndonjë adresë të caktuar, sikur nuk mban qëndrim, sikur nuk shpreh asnjë ndjenjë; por faktet, detajet janë zgjedhur e vendosur në atë mënyrë, sa që komizmi i tyre i brendshëm del vetvetiu pa asnjë përpjekje nga ana e treguesit. Shembull:

« — Nuse — i tha vjehrra — pa dil e shih, të keqen, bie shi?

— S'më lënë pikat e strehëve të shoh, nëno...»⁶³

Përveç vendosjes së posaçme të fakteve, ndonjëherë, efektet humoristike arrihen edhe nëpërmjet hiperbolës, groteskut, bile dhe elementit burlesk, apo nëpërmjet zgjedhjes dhe përdorimit të veçantë të epitetit, metaforës, krahasimit etj. Dikush, p.sh., është aq kokëfortë, sa që «me i ra njiqind herë me spatë kresë, s'i nxjerr kurrnji ashkël»; dikush thirret me epitete të tilla si «i gjori», «i varfëri»; «fakiri» «loci» etj., që shqipërohen me një intonacion të veçantë humoristik. Ka dhe raste kur efektet humoristike krijohen duke shfrytëzuar mundësitë e pashtershme komike të gjuhës, fjalët e papritura, pikante, bile dhe «të pahijshme», shprehjet komike e me peshë të madhe specifike dhe konstruktet e veçanta sintaktike. Veç kësaj shfrytëzohet me mjeshtëri polisemia e fjalës, kuptimet e saj të dyta metamorfike, homonimia (sidomos kur është puna për dy persona që flasin

60) Për ekscentrizmin si një formë të artit Lenini ka thënë: «Këtu ka diçka satirike, ose skeptike ndaj të zakonshmes, ka një tendencë për ta kthyer atë sëprapthi, për ta deformuar, për të treguar alogjizmin e së zakonshmes. Diçka e trilluar, por interesante». (*Lenini për kulturën dhe artin*, Tiranë, 1960, f. 571).

61) J.U. Jarnik, MHFSH-I, f. 359.

62) AIF, KH, v. 3, f. 74.

63) AIF, JP, fl. 15, f. 18.

dialekte ose gjuhë të ndryshme) etj. Kështu, disa «subjekte» anektodike kanë për bazë keqkuptimet gjuhësore:

«— Ku shkon?

— Nuk shkoj, po kthehem.

— Ku e ke shtëpinë?

— Në mes të oborrit dhe me derë nga lesa.

— Qenke i trashë ti!

— Ohu, të shikosh vëllanë tim! Ta çash, dy bëhen!»⁶⁴

Së fundi, duhet thënë se jo rrallë anekdota shfrytëzon dhe poezinë dhe prozën ritmike dhe rimën midis fjalëve që duhet të theksohen:

— «Yf, na qelbe! Paskë hangër hudër...

— Ça me ba, moj Lenë, dikush me *hudër* e dikush me *pudër*...»⁶⁵

Pavarësisht nga mënyra se si arrihet, humori i anekdotës zakonisht nuk është diçka në vetvete, diçka si shkaktar i një të qeshure që shuhet pa lënë asnjë mbresë, por vë në lëvizje botën ideoemocionale të njerëzve, i shqetëson ata, i shtyn të përpiqen ta kuptojnë e ta shijojnë komiken dhe të mbajnë një qëndrim të caktuar. Kjo përcakton rëndësinë shoqërore të humorit të anekdotës dhe i jep atij cilësinë e mjetit për zbulimin e komikes dhe për fshikullimin e negatives.

Shpesh në anekdotat takohemi me shprehje, vërejtje e replika të mprehta, që janë gjykime për fakte e shfaqje të ndryshme, një farë krahasimi i papritur, i përnjëhershëm e tepër lakonik dhe zbulon komizmin e asaj për të cilën bëhet fjalë në moment, në mënyrë të rrufeshme. Në këto raste të një talljeje të mprehtë mendimi shpesh nuk qëndron në sipërfaqe, por ka diçka si nëntekst, që kërkon një farë përpjekjeje për ta kapur, kërkon zgjuarsia edhe nga dëgjuesi:

« — Sa bëjnë 2 x 4, o xhaxho? — i thotë dikush një bariu për ta tallur.

— Po të vëmë dhe veten tënde nga prapa, bëjnë 120...»⁶⁶

Një mjet tjetër që përdor anekdota për të vënë në lojë negativën është dhe ironia. Në këtë rast paraqitet si pozitive, flitet me «entuziazëm», lavdërohet jashtë mase ajo që në esencë është negative, që në të vërtetë duhet qortuar e, në fakt, qortohet. Nastradini, p.sh., e lavdëron aq shumë vezirin, flet me aq pasion për «meritat» e tij, sa që, në fund të fundit, nënvizon se merita të vërteta tek ai nuk ka.⁶⁷ Ironia e anekdotës, në pajtim me karakterin e komikes, është herë e lehtë (kur vihen në lojë të meta të tilla si naiviteti, ëndërrimi pa baza, padituria e njerëzve të zakonshëm), herë e hidhur (në anekdotat që japin aspekte nga varfëria e masave punonjëse në të kaluarën etj.), herë e mprehtë dhe përvëltonjëse (kur sulmohen përfaqësuesit e klasave shfrytëzuese të së kaluarës, armiq të tanë të sotëm të klasës etj.), por ajo është gjithnjë një armë e dashur e anekdotës, e përdorur me shumë mjeshtëri dhe për arsye të ndryshme, sidomos për të fshehur talljen, kur ishte puna për regjime dhe njerëz të së kaluarës që nuk pranonin kritikë.

Shpeshherë tallja satirike e anekdotës i kalon caqet e humorit dhe të ironisë dhe arrin në sarkazëm. Në këtë rast tallja është tepër e hidhur, tepër therëse, plot helm, zemërim e urrejtje; tregimtari nuk bën asnjë

64) AIF, JP, v. 14, f. 106.

65) AIF, Gj.Sh., 13/1, f. 162.

66) *Hosteni*, 13/1960, f. 10.

67) Gj. Karma *vep. e cit.*, f. 140.

përpjekje për të përmbajtur ndjenjat e veta, por përdor gjithë forcën e vet për të demaskuar deri në fund kundërshtarin, për t'i dhënë atij goditje të forta, energjike. Sarkazma lidhet kryesisht me komiken shoqërore; ajo përdoret për të fshikulluar armiq të tillë klasorë të masave punonjëse si beun, aganë, priftin, zyrtarin e regjimeve antipopullore etj.

Karakteri komik i objektit të pasqyrimin të anekdotës provokon të qeshurën. E qeshura mund të jetë shpërthënjëse, e lehtë apo edhe e brendshme, por është një element i përhershëm i anekdotës, është arma e saj kryesore, është — po të shprehemi me fjalët e N. Gogolit — një personazh i ndershëm, fisnik, gjithmonë aktiv. Ky rol i së qeshurës në anekdotë përcaktohet nga fakti se ajo shpreh një kompleks të tërë ndjenjash e shërben jo vetëm si armë për zbulimin e komikes, por dhe si armë lufte kundër negatives, dhe si mjet për të kuptuar e shprehur epërsinë e pozitives ndaj negatives. Në anekdotë, pra, ka siç thuhet, të qeshur e të qeshur. Gjithshka varet nga fakti se me kë dhe për ç'arësye qeshim. E qeshura është e lehtë, pa të keq, kur është puna për komiken «elementare», dashamirëse, kur është puna për diçka pozitive, por sarkastike e therëse, kur është puna për komiken shoqërore.

Sa u thanë më lart për karakterin komik të anekdotës nuk e zbehim aspak qëllimin, detyrat dhe qëndrimin e saj serioz ndaj objektit të pasqyrimin. Asaj do t'i shkonin shumë mirë fjalët e Marksit: «... ndaj qesharakes unë sillem në mënyrë serioze, kur tallem me të». ⁶⁸

Një tjetër karakteristikë dalluese e anekdotës është rreptësia dhe sensi i theksuar i masës, lakonizmi i saj, koncizioni lapidar, thujtë epi-gramatik. Kjo duket në përmbajtjen e saj, në shtrirjen, kompozicionin, gjuhën etj.

Anekdotat ndërtohet gjithnjë mbi një episod a fakt të vetëm. Kjo e dallon në mënyrë të qartë, p.sh., jo vetëm nga përrallat e mirëfillta, por edhe nga ato realiste — humoristike, me të cilat anekdotat ka shumë afëri. Kështu, kur disa anekdotat, në të cilat del e njëjta ide dhe i njëjti personazh, bashkohen në një tregim të vetëm, përbëjnë një përrallë realiste-humoristike; kurse kur një përrallë e tillë zërthehet në episode të veçanta, kemi disa anekdotat. Në përrallën «Tri dredha shpine», ⁶⁹ p.sh. Qerozi, në rolin e shërbëtorit, kryen disa veprime kundër zotërisë; por ka dhe anekdotat, ku del prapë po ky personazh duke vepruar kundër zotërisë, veçse tani kryen vetëm një veprim në çdo anekdotë. Kjo ndodh edhe me priftin, kadiun Nastradin, beun etj. Edhe numri i personazheve të anekdotës është i kufizuar. Zakonisht dalin dy personazhe, që përfaqësojnë dy anët e kontradiktës. Kështuqë rregulli i veprimeve dhe i personazheve trishe, që vihet re në përrallat fantastike, novelistike etj., tek anekdotat nuk ekziston. As formulat hyrëse e mbyllëse, as përsëritjet dhe retardacionet, karakteristike për llojet e sipërpërmendura të përrallave, as bishti moralistik i fabulave nuk praktikohen tek anekdotat. Ndonjëherë anekdotat bënë një ekspozim fare të shkurtër, vetëm me një frazë, një farë prezantimi me situatën e me personazhet vepruese dhe na çon kështu përnjëherësh te veprimi, bile shpesh mungon edhe ky ekspozim dhe anekdotat fillon e mbaron me dialog. Zhvillimi i «subjektit» bëhet sa më shkurt, pa prolik-sitet; gjithë «subjekti» përbëhet nga veprimi, nga lëvizja, që përjashtojnë çdo përshkrim, staticizëm e analizë psikologjike dhe zbulojnë në mënyrë

68) K. Marks i F. Engels ob isskustve, Moskë, 1957, t. II, f. 457,

69) PP-I, f. 333.

të drejtpërdrejtë karakterin e personazhit. Por gjithë vëmendjen e saj, gjithë forcën anekdota e përqendron në frazën e fundit, ku është dhe pika kulminante. Këtu ajo shpreh, në mënyrë sa më të ngjeshur, të mprehtë e të papritur, mendimin e saj kryesor. Prandaj ritmi i kësaj fraze është veçanërisht i shpejtë, fjalët janë tepër të kursyera, fjalitë apo fjalët ndërmjetëse e sqaruese kufizohen në maksimum. Në këtë mënyrë shtrirja e anekdotës në hapësirë është e shkurtër, tendenca e saj është që të paraqitet me dimensione sa më të kufizuara.

Të gjitha këto bëjnë që anekdota të dallohet për stilin e saj të gjallë, të shkathët, plot temperament, relief e dinamizëm.

Karakteristike është dhe gjuha e anekdotës. Bie në sy raporti i saj i drejtë me mendimin, humori dhe realizmi i saj, konçiziteti dhe gjallëria, karakteri direkt dhe i guximshëm. Gjuha e anekdotës dallohet kështu për shprehjen konkrete, për koloritin lokal dhe individual, për fjalët pikante e të fuqishme, për shprehjet humoristike, për replikat e mprehta dhe lodrat e goditura të fjalëve. Fraza e anekdotës zakonisht është e shkurtër, e lehtë, elastike. Anekdotës i pëlqejnë shumë fjalitë nominative, eliptike, asintetike, konstruktet pjesore etj. Dialogu është i saktë, i shkathët, me kolorit dhe ndihmon për zbulimin e komikes dhe për krijimin e efekteve humoristike, duke vënë në dukje qëndrimin e personazheve, aftësitë apo të metat e tyre duke shfrytëzuar «disonancat» dhe keqkuptimet gjuhësore, alogjizmat e kontradiktat në të folur etj.

Një rol të veçantë në anekdotë lozin elementet dramatike — intonacioni, gjesti, mimika.

Intonacioni shpreh qëndrimin e treguesit ndaj asaj për të cilën tregon, ai është kyçi që ndihmon zbulimin e komikes dhe të idesë, bile, në disa raste, i vetmi mjet në këtë drejtim. Kjo duket, p.sh., në rastin e ironisë. Intonacioni është gjithashtu në bazën e stilit të anekdotës, përcakton këtë stil, organizon punën me të. Sigurisht ai nuk është diçka me vete, por te gjuha, te ligjërimi. Ai duket në ndërtimin e frazës, në kriterin e zgjedhjes së fjalëve dhe vendosjes së tyre në fjali, në rezonancën e fjalës, në shkallëzimin tonik të zërit, në ritmin e tregimit, në shfrytëzimin e pauzës etj. Për anekdotën është karakteristik intonacioni humoristik, ironik e sarkastik. Ai është zakonisht i qetë, thuhetse horizontal në rastin e humorit, i dallgëzuar në rastin e ironisë, pickkonjës, me hypje e zbritje të forta e të përnjëhershme në rastin e sarkazmës etj.

Gjesti dhe mimika e treguesit ndihmojnë gjithashtu për të përcaktuar qëndrimin ideor të tij ndaj fakteve e personazheve, për të shprehur ndjenjën e tij, për të zbuluar më mirë idenë e anekdotës dhe komizmin e saj. Ka pastaj anekdota, si ato për memecët etj., që janë ndërtuar krejtësisht mbi bazën e gjestit e të mimikës; prandaj vetëm mund të tregohen, ose, më mirë, të interpretohen e nuk mund të shkruhen.

Rëndësinë që kanë elementet dramatike mund ta kuptojmë po të vëmë re efektin e ndryshëm të së njëjtës anekdotë kur e dëgjojmë dhe kur e lexojmë, apo kur e dëgjojmë nga një tregimtar i zoti e nga një ordiner, po të vëmë re sa humbet ajo në rastin e dytë. Mund të themi, pra, se jetën e saj të vërtetë artistike anekdota e bën në gojën e popullit. Këtë del dhe roli i veçantë i tregimtarit, i cili, kur është i shkathët dhe i talentuar, di jo vetëm të përdorë me mjeshtëri elementet e sipërtreguar, por di të zgjedhë dhe momentin e tregimit dhe subjektin e përshtatshëm anekdotik.

*

Duke marrë parasysh veçoritë e përmbajtjes dhe të formës artistike të anekdotës, do të mund të thoshim se ajo është një tregim i shkurtër humoristik apo satirik me karakter realist, që ndërtohet mbi një fakt të vetëm komik, ka një pikë kulminante të shprehur në mënyrë të mprehtë dhe përfundim të papritur.

Ndonjë nga këto veçanti, ose disa prej tyre, mund t'i gjejmë edhe në llojet e tjera të tregimit folklorik, por në asnjë rast tjetër s'i gjejmë të gjitha së bashku. Nga ana tjetër, në tregimet e tjera ka veçori që s'i gjejmë tek anekdota, p.sh. fantazia e përrallës së mirëfilltë, «të vërtetë», e mbinatyrshmja e legjendës, simbolizmi dhe alegoria e fabulës etj. Të gjitha këto e dallojnë anekdotën jo vetëm nga përralla fantastike apo nga fabula, por edhe nga përralla realiste-satirike edhe nga gojëdhëna, tek të cilat mund të ketë elemente të ndryshme anekdotike. Në këtë mënyrë anekdota përbën një lloj të veçantë të tregimit folklorik.

Ndërgjegja popullore i është drejtuar këtij lloj tregimi, anekdotës, në kushte dhe rrethana të caktuara historike-shoqërore e për të plotësuar kërkesa ideo-estetike të kondicionuara nga këto kushte e rrethana. Mund të përmendim, fjala vjen, kohën kur popullin nuk e kënaqte më fantazia e përrallës ose simbolizmi i fabulës, kur ai e ndjente të nevojshme që të shprehte në mënyrë më të drejtpërdrejtë mendimet e tij për jetën dhe njerëzit dhe protestën kundër padrejtësive shoqërore. Dhe meqë anekdota, për shkak të përmbajtjes, qëllimeve të saj dhe formës artistike, e kryen shumë mirë rolin e armës humoristike e satirike në duart e popullit, është përdorur nga ai për të fshikulluar negativën, imoralen, të paarsyeshmen. Ja pse anekdota ka lulëzuar sidomos në ato periudha të historisë sonë kur kontradiktat antagoniste ishin bërë veçanërisht të ashpra, kur protesta e popullit ishte rritur (le të kujtojmë, p.sh., periudhën zogolliane). Mund të themi, pra, se koha për të cilën flitet në shumicën e anekdotave ka mbetur pas; por as rëndësia, as terreni i tyre nuk ka humbur; jo vetëm se ato na bëjnë të njohim jetën, mendimet politike dhe parimet etike-tradicionale të popullit tonë, apo marrëdhënjet shoqërore në të kaluarën, por edhe se nxjerrin në pah e fshikullojnë shfaqje të ndryshme negative të realitetit tonë, shfaqje që shprehen në formën e ndikimeve dhe mbeturinave të huaja në jetën dhe në ndërgjegjen e njerëzve. Nga ana tjetër, siç u tha dhe më lart, anekdota, duke pasë si objekt pasqyrimi komiken, lidhet me kontradiktën, e cila, pavarësisht nga karakteri, është një gjendje e përhershme e sendeve dhe e fenomeneve. Veç kontradiktave joantagoniste që ekzistojnë sot në gjirin e popullit, p.sh., ekzistojnë dhe kontradikta antagoniste midis nesh dhe armiqtë tanë — imperialistëve, revizionistëve modernë dhe reaksionarëve ⁷⁰.

Në këtë gamë të gjerë kontradiktash anekdota gjen nga ato që mund të bëhen objekt i saj i pasqyrimin, që mund të zbulojnë karakterin komik, karakterin e ulët e qesharak të së vjetrës, reaksionares dhe negatives. Në këtë mënyrë, anekdota ka një fushë të gjerë veprimi edhe në ditët tona. Sigurisht, pohime të tilla, si ai i Lesingut se «në gjithë moralin s'ka ilaç më efikas, më të fortë sesa nxjerrja në shesh e qesharakes» ⁷¹, kanë një vlerë relative e të kufizuar jo vetëm për epokën tonë, por edhe për vetë anekdotën. Një ilaç i tillë mund të jetë më efikasi e më i forti për

70) Enver Hoxha, *Raport mbajtur në Kongresin V të PPSH*, T. 1966, f. 129.

71) *Anekdoty ob hoxhe Nasredine*, f. 3.

kushtet e marrëdhënjeve shfrytëzuese, për kushtet që rritin frymën kritike në pjesën përparimtare të shoqërisë; kurse në realitetin tonë socialist, ku këto kushte janë eliminuar njëherë e përgjithmonë, edukimi nëpërmjet shembullit negativ merr një vlerë të kufizuar dhe zëvendësohet me edukimin nëpërmjet shembullit pozitiv. Kryesisht këtë rrugë të fundit ndjek populli ynë sot me krijimet e veta poetike; se edhe me anekdotën qëllimi i tij është t'i kundërvejë negatives pozitiven, ta sanksionojë këtë të fundit, të tregojë mbizotërimin e saj ndaj negatives.

Të gjitha këto i sigurojnë anekdotës, edhe në ditët tona, atë jetë aq të gjallë e aktive, për të cilën ne jemi dëshmitarë.

R é s u m é

A PROPOS DE L'ETUDE DES ANECDOTES POPULAIRES

L'auteur est de l'opinion que malgré la très ample diffusion et la grande portée de cognition, éducation et artistique, l'anecdote a été laissée en quelque sorte à l'écart de l'attention des folkloristes. Ce fait, ajouté aux opinions contrastantes qui se manifestent, la nouvelle position des questions à partir de positions idéologiques, scientifiques et esthétiques différentes, soulèvent la nécessité de soumettre à un débat ultérieur de telles questions que sont: la place de l'anecdote entre les autres genres de la narration folklorique, la spécifique du contenu et de sa forme, les critères de classement, etc. C'est précisément dans cet esprit que l'auteur jette un regard critique aux opinions exprimées à tout ce jour sur ces questions.

Pour ce qui est des anecdotes albanaises, l'auteur croit que, sur la base du critérium thématique-idéologique (il considère inexacte la division d'après les personnages), elles peuvent être divisées en trois groupes principaux: anecdotes sur les rapports de classe, les rapports domestiques, les caractéristiques individuelles.

Après avoir analysé le contenu de chaque groupe (avec les sous-groupes respectifs), il arrive à la conclusion que les anecdotes reflètent la lutte de classe (en tout premier lieu celle des opprimés contre les oppresseurs) sous l'aspect économique, politique et idéologique, sur le front intérieur et extérieur. Il trouve, en même temps que des maximes solides, aussi des limitations idéologiques des masses dans le passé, ainsi que des infiltrations de l'idéologie de classes régnantes.

Jetant un coup d'oeil aux personnages des anecdotes albanaises, l'auteur distingue des personnages positifs (représentants des masses laborieuses) et négatifs (représentants des classes régnantes du passé ou porteurs des opinions et de l'idéologie de ces derniers). Il s'arrête à la question des personnages typiques et analyse surtout le bey, le cadî, le prêtre, le *balliste* (suiveur du *Balli Kombëtar*, une organisation de la félonnie du temps de l'occupation), le laquais. L'auteur discerne, sur un autre plan, des personnages inventés et historiques, ainsi que des personnalités locales et nationales. Il s'arrête tout particulièrement à la figure de Nasredin Hodja, en admettant son origine orientale, mais en soulignant que l'attention principale ne doit être centrée chez le Nasr-ed-Dine historique mais sur le fait de qui est-il le représentant, quelles idées et quelles caractéristiques porte cette figure dans les anecdotes de plusieurs peuples, comment a-t-elle été réalisée au point de vue de l'art, etc.

Parlant de la poétique et du style des anecdotes, l'auteur souligne le caractère réaliste de celles-ci (cela non pas du fait qu'elles représentent des «instantanées photographiques», mais un aboutissement artistique de la réalité), les caractéristiques propres de la trame anecdotique: les situations piquantes, les propos aigus, les

hyperbolisations, la fantaisie spécifique, etc.; le caractère de comicité de l'objet de reflet de l'anecdote, les moyens de la moquerie anecdotique, le rôle du rire, le fait que la typisation anecdotique est obtenue surtout au moyen de la synthèse.

Il souligne également les proportions circonscrites de l'anecdote (brièveté, concision) le style agile et à tempérament la communication puissante avec l'auditoire, la sagacité de l'anecdote, l'aboutissement imprévu, l'appui sur un seul fait, etc. Il illustre aussi plusieurs traits particuliers de la langue de l'anecdote ainsi que le rôle des éléments dramatiques: intonation, geste, mimique.

Après l'analyse idéologique, stylistique et fonctionnelle de l'anecdote, l'auteur croit qu'elle peut être définie comme un conte bref humoristique ou même satirique de caractère réaliste, construit sur un seul fait se prêtant au comique, qu'elle offre un point culminant exprimé de façon sagace et un aboutissement imprévu. Ces caractéristiques, prises ensemble, sont distinctives pour l'anecdote, c'est pourquoi elle constitue un genre particulier de la narration folklorique.

L'auteur croit également que l'agilité, l'élasticité, la capacité de connexion de l'anecdote avec la réalité, le brièveté, etc., font que l'anecdote soit un des genres les plus vivaces et des plus actifs de la narration folklorique.